



EULEX

RAPORTI PËR PROGRAMET 2011

PËRKRAHJA E SUNDIMIT
TË LIGJIT NË KOSOVË:
VLERËSIM I GJENDJES



EULEX | RAPORTI PËR PROGRAMET 2011

PËRKRAHJA E SUNDIMIT
TË LIGJIT NË KOSOVË:
VLERËSIM I GJENDJES

LISTA E SHKURTESAVE

VK	Vendkalim kufitar
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hetuese
PeK	Policia e Kufirit
CARDS	Programi i ndihmës për rindërtim, zhvillim dhe stabilizim
SCL	Sistemi i caktimit të lëndëve
SIML	Sistemi Informativ për menaxhimin e lëndëve
KIE	Këshilli i Evropës
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
DFM	Departamenti i Mjekësisë Ligjore
DMF	Departamenti për Migracion dhe të Huaj
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DFID	Departamenti i MB për Bashkëpunim Ndërkombëtar
DKO	Drejtoria për Krim të Organizuar
PQ	Prokuroria Publike e Qarkut
KE	Komisioni Evropian
ECLD	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
EPAP	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EU-CTA	Përkrahja e BE-së për administratat doganore dhe tatimore
EUROJUST	Njësia e BE-së për bashkëpunim gjyqësor
EFKK	Ekipe fleksibile kundër kontrabandës
FIQ	Forumi për iniciativë qytetare
FRY	Ish Republika e Jugosllavisë
FYROM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
QK	Qeveria e Kosovës
NJAEI	Njësia kundër mjeteve eksplozive të improvizuara
MIK	Menaxhimi i integruar i kufirit
ICG	Grupi për Kriza Ndërkombëtare
ICITAP	Programi ndërkombëtar i ndihmës për trajnim në hetimet penale
KGJPN	Këshilli gjyqësor dhe prokuroria ndërkombëtare
NJN	Ndihma juridike ndërkombëtare
BLN	Bashkëpunimi ligjor ndërkombëtar
PBI	Puna policore e bazuar në inteligjencë
NJBLN	Njësia për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar
IPA	Instrumenti i ndihmës gjatë para-anëtarësimit
ISDN	Rrjeti i shërbimeve të integruara digjitale
NJAGJ	Njësia për auditim gjyqësor
ZGJPVV	Zyra gjyqësore dhe prokuroriale për verifikim dhe vlerësim
DK	Dogana e Kosovës

SHDK	Shërbimi Doganor i Kosovës
KIPRED	Instituti kosovar për hulumtim dhe zhvillim të politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli prokuroria i Kosovës
SIPK	Sistemi informativ i Policisë së Kosovës
QKSS	Qendra kosovare për studime të sigurisë
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
AVUK	Agjencia e veterinarisë dhe ushqimit të Kosovës
KKSK	Këshillat komunale për sigurinë e komuniteteve
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
MMK	Monitorim, mentorim, këshillim
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MiM	Memorandum i Mirëkuptimit
OJQ/OSHC	Organizatë joqeveritare /Organizatë e shoqërisë civile
ZAD	Zyra e avokatit disiplinues
OMIK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OMPF	Zyra për persona të pagjetur dhe mjekësi ligjore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
NJMO	Njësia për mbështetje operative
DAP	Doracaku për administratën e prokurorisë
SIMP	Sistemi informativ për menaxhimin e prokurorisë
LPP	Ligji i prokurimit publik
PP	Prokuroria publike
SRHN	Seksionet rajonale për hetimin e narkotikëve
KOS	Korniza operative strategjike
NJSI	Njësia speciale intervenuese
PSO	Procedura standarde të operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
TAIEX	Instrumenti i KE-së për Asistencë Teknike në Shkëmbimin e Informatave
TIMS	Sistemi i menaxhimit të informatave tregtare
SHDU	Shërbimi doganor i UNMIK-ut
KB	Kombet e Bashkuara
UNCTAD	Konferenca e KB për Tregti dhe Zhvillim
OHCHR	Zyra e Komisarit të Lartë të KB për të Drejtat e Njeriut
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i KB në Kosovë
UNODC	Zyra e KB për Drogë dhe Krime
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE NGA SHEFI I MISIONIT EULEX	04
HYRJE	05
PJESA 1:	
Përditësime dhe zhvillime: korrik 2010 / qershor 2011	07
PJESA 2:	
Përcjellja e progresit – dhjetor 2008 / qershor 2011	13
POLICIA	
Luftimi efektiv i krimeve	16
Sigurimi i kufijve	20
Patrullimi efektiv dhe sigurimi i rendit publik	22
Krijimi i një organizate të qëndrueshme	26
DREJTËSIA	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjyqtarët	32
Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurorët	38
Lëndët penale dhe civile	42
Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Mjekësisë Ligjore.....	45
Shërbimi Korrektues i Kosovës	47
DOGANA.....	52
Fusnotat	55
Bibliografia	58
Falënderime	61

Parathënie nga Shefi i Misionit

EULEX

Xavier Bout de Marnhac



EULEX-i është mision i CSDP-së që karakterizohet me një kombinim unik të mandatit ekzekutiv dhe jo ekzekutiv. Misioni shfrytëzon mandatin e vet ekzekutiv për kryerje të arrestimeve, hetimeve, ndjekjeve dhe gjykimeve të personave të dyshuar dhe për udhëheqjen e operacioneve në fushën e mjekësisë ligjore dhe të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Përveç mandatit të vet ekzekutiv, misioni po ashtu është i ngarkuar që të shtyj përpara dhe të ndihmojë sistemin e drejtësisë së Kosovës i cili është duke u përpjekur të përmbushë kushtet për të qenë transparent, i përgjegjshëm, shumetnik dhe pa ndonjë mundësi të ndërhyrjeve politike, të gjitha këto në pajtim me praktikatat më të mira dhe standardet evropiane. Kjo me siguri është pjesa më e rëndësishme e mandatit dhe ajo zbatohet përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK) ku stafi i EULEX-it vepron krahpërkrah me homologët e tyre kosovarë gjatë punëve dhe detyrave të tyre rutinore. Ky angazhim evropian në gjithë Kosovën thekson masën për të cilën progresi i qëndrueshëm në këto fusha konsiderohet esencial jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin dhe gjithë BE-në.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre kushteve misioni ka caktuar synimet e veta aftshkurtëra, të mesme dhe afatgjata. Për të gjitha synimet afatshkurtra është arritur pajtimi me institucionet vendëse të Kosovës sikurse edhe me Komisionin Evropian. Këto synime, mes tjerash kanë të bëjnë me: hartimin dhe zbatimin e legjislacionit specifik; zbatimin e procedurave të standardizuara brenda të gjithë sektorëve të sistemit të drejtësisë së Kosovës; emërimin e zyrtarëve; dhe mbështetjen për asistencën teknike e cila ofrohet përmes instrumenteve të ndryshme të BE-së.

Për EULEX-in është me rëndësi që të vazhdohet me të arriturat nga MMK dhe ndryshimin organizativ të sektorit të sundimit të ligjit, duke përfshirë “infrastrukturën” e porsaformuar të sistemit të drejtësisë.

Të mos harrojmë se, deri në vitin 2008 sistemi i drejtësisë udhëhiqej nga ndërkombëtarët, kurse gjatë dekadës së fundit policia ashtu edhe dogana kanë përfituar nga asistenca masive dhe nga shkalla e lartë e autonomisë operacionale. Në këtë kontekst, me përpjekjet tona të lidhura me MMK po ashtu do të insistojmë për veprime të përshtatura me qëllim të mbështetjes së luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjithnjë duke pasur parasysh domosdonë e kundërshtimit të ndërhyrjeve politike nëpër institucionet e pavarura. Këso ndërhyrjesh ishin regjistruar dhe vazhdojnë të regjistrohen nga ky mision.

Do të përfundoja duke shfrytëzuar rastin për të falënderuar partnerët tanë të Kosovës të cilët punojnë në fushën e sundimit të ligjit për përkushtimin dhe angazhimin e tyre. Njëkohësisht, shfrytëzoj rastin për të falënderuar stafin e EULEX-it për punën e tyre të zellshme dhe përkushtimin ndaj mandatit të misionit të MMK-së i cili është i reflektuar në raportin në vazhdim. Unë jam i sigurt se duke vazhduar punën së bashku dhe rritjen e partneritetit tonë ne do të arrijmë edhe rezultate tjera për të mirën e popullit dhe të sundimit të ligjit.

HYRJJE

Me vendosjen e misionit EULEX në dhjetor 2008, një prej objektivave kryesore ishte krijimi i një harte e cila do të përfshinte fuqitë dhe dobësitë në fushën e sundimit të ligjit, në secilën pjesë të institucioneve të ndryshme. Harta, e cila përbëhet nga një vlerësim i plotë i performancës së sistemit për sundimin e ligjit ishte finalizuar në qershor 2009, e cila e ka çuar misionin në publikimin e raportit bazik. Në bazë të dobësive të identifikuara në raportin bazik, këshilltarët e EULEX-it kishin dizajnuar projekte në shkallë të vogël dhe të mesme, në partneritet të ngushtë me homologët e tyre vendës. Lidhur me zbatimin e këtyre veprimeve korrigjuese përparësia i ka takuar gjithmonë institucioneve vendëse të sundimit të ligjit, në mënyrë që të sigurohej pronësia e tyre ndaj rezultateve të procesit të MMK.

Ambicia e raportit është të sigurojë një standardizim kundruall raportit bazik të publikuar në vitin 2009. Përtej një rishikimi të zhvillimeve gjatë 12 muajve të fundit, ky raport do të sigurojë një rishikim analitik të progresit të arritur që nga fillimi i këtij misioni. Analiza bazohet në zhvillimet e monitoruara prej qindra pjesëtarëve të misionit të cilat janë regjistruar nga misioni gjatë 30 muajve të fundit.

Studimi është i ndarë në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë ofron një përditësim të ndryshimit të dinamikës së regjistruar në 12 muajt e fundit, një fiksion i të gjitha fushave në të cilat punojnë këshilltarët për MMK të EULEX-it. Pjesa e dytë është më shumë me orientim kah procesi dhe siguron një standardizim kundruall dobësive të vërteta – të futura nëpër referenca për lehtësim të referimit – të cilat ishin raportuar në raportin bazik për vitin 2009. Ky standardizim vjen në përfundimin se institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë me të vërtetë kanë shënuar përparim dhe po ashtu identifikon fushat me pika të dobëta të vazhdueshme.

Policia e Kosovës është duke marrë më shumë detyra dhe i është nënshtruar një procesi të menduar mirë për ristrukturim organizativ. Menaxhmenti strategjik është duke treguar një kapacitet të prekshëm për të udhëhequr me ndryshime krahas me kualitetin. Perceptimi i opinionit publik është atestuar përmes një niveli të mirë të besimit. Janë identifikuar edhe kushtet për të udhëhequr me vazhdimin e modernizimit të shërbimit në mënyrë të suksesshme dhe po ashtu përparimin me standardet e BE-së për policinë. Sfidat përpara janë të qarta. Do të jetë me rëndësi që të mbahet një hap i mirë i zbatimit në fushat strategjike si, menaxhimi i burimeve, modelet për policinë në komunitet, orientimi i shërbimit në bazë të informacionit nga inteligjenca, kapacitete për të ndërprerë aktivitetet e kimit të organizuar, ndërtimin e kapaciteteve për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Sistemi i drejtësisë vazhdon të ndërtohet dhe është duke treguar shenja të progresit. Janë miratuar një mori ligjesh me qëllim të kompletimit të “infrastrukturës” ligjore. Zbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të jetë me ndikim makroskopik për sistemin dhe kjo është arsyeja se përse është vënë në fokus konsolidimi i kapaciteteve

dhe i kompetencave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Është bërë një lustrim dhe rrimërim i gjykatësve dhe prokurorëve. Moshë mesatare për një gjykatës tani është rreth 50 vjeç, ndërsa në vitin 2009 ishte rreth 60 vjeç. Pagat janë rritur dhe gjykatat janë rinovuar. Sistemet e rekrutimit dhe të disiplinës janë të pavarura. Perceptimi i publikut është se ende flitet për një sistem të dobët, i dëmtuar nga lëndët e korrupsionit dhe nënshtrimet politike ose presionet e jashtme. Sfidat përpara janë të shumta dhe të një natyre shumë komplekse, si bie fjala miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ose të Ligjit mbi Personat e Pagjetur. Përmirësimet në nivel të përmbartimit të vendimeve gjyqësore, zvogëlimit të lëndëve të grumbulluara, të besueshmërisë, dhe të një paanshmërie të mirfillt, ende janë synime të cilat duhet të mbërrihen. Vlen të përmendet një konstatim pozitiv për Ministrinë e Drejtësisë e cila në mënyrë të shtuar është duke marrë përgjegjësinë për bashkërendimin e shumë përpjekjeve dhe aktiviteteve nga rrafshi i kompetencave të veta.

Dogana e Kosovës ka mbajtur një nivel të mirë të performancës dhe modernizimi i agjencisë është duke vazhduar. Kapaciteti për të mbledhur të hyrat është stabil. Përdorimi i përbashkët i mjeteve/ pajisjeve me policinë dhe integrimi i shërbimeve në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit kërkon një angazhim më aktiv.

Në nivelin strategjik, Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit¹ merret me bashkërendimin e të gjitha çështjeve të lidhura me rrafshin e sundimit të ligjit në Kosovë. Funkionimi efektiv i sekretarisë së bordit dhe këmbimi më i mirë i informacionit janë treguar të suksesshme në kuptim të prioritizimit të aktiviteteve dhe të sinkronizimit të detyrave. Legjislacioni dhe zbatimi i aktiviteteve të kërkuara për këtë vit me qëllim të arritjes së pikave pozitive për Raportin e Progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian tashmë janë të njohura. Institucionet e sundimit të ligjit dhe agjencitë duhet të intensifikojnë veprimet e veta në këtë drejtim. Data e caktuar për këtë

qëllim është afër, por arritjet janë ende të mundshme.

Progresi i institucioneve të sundimit të ligjit dhe i agjencive po ashtu nënkupton progresin që shpie drejt përfundimit të misionit. Ky skenar do të mund të shihej “në horizont”, por ne thjesht ende nuk kemi arritur deri aty. Sistemi i sundimit të ligjit është ende duke u formësuar. Harta ende nuk i ka të gjitha pjesët e saj në vendin e duhur.



The Joint Rule of Law Coordination Board

Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit

PJESA 1

Përditësime mbi
zhvillimet: korrik 2010 /
qershor 2011

Tabela në vijim jep një pasqyrë të progresit të arritur të institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë, në fushat ku EULEX-i është duke nxitur ndryshimet organizative.

FUSHA E SUNDIMIT TË LIGJIT	SEKTORET	2011 kr 2010 2010 kr 2009	
		A	B
POLICIA	Luftimi efektiv i krimeve	A	B
	Patrullimi efektiv dhe sigurimi i rendit publik	A	B
	Sigurimi i kufijve	A	A
	Sigurimi i organizimit të qëndrueshëm	A	B
DREJTËSIA	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	A	B
	Gjyqtarët	B	B/C
	Këshilli Prokurorial i Kosovës	B	B/C
	Këshilli i Prokurorëve	B	B
	Ministria e Drejtësisë	B	B/C
	Departamenti i Mjekësisë Ligjore	C	B/C
	Shërbimi Korrektues	A	A/C
DOGANA	Integrimi i Strategjive të Qeverisë në plane operative	B	B
	Përmirësimi i komunikimit të brendshëm	B	B/C
	Bashkëpunimi me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit	B	B
	Strategjia për Menaxhim të Integruar të Kufirit	B	B/C

A = Progres

B = Progres i ngadalshëm/ Nevojitet nxitje

C = Problematik/ progres shumë i kufizuar ose pa progres

D = Shqetësim serioz/ regresion

Në fushën e **policisë**, PK ka arritur të përparojë me ndryshimet organizative përmes arritjes së disa reformave pozitive. Vlen të theksohet se menaxhmenti i mesëm dhe i lartë i PK, veçanërisht nga mesi i vitit 2010, ka demonstruar një aftësi të vazhduar në kryerjen e ndryshimeve organizative në shkallë më të gjerë.

Përkritazi me procesin e reformimit të kornizës ligjore të PK-së, përparim është shënuar me revidimin e Ligjit për Policinë që ka përfunduar në fillim të muajit prill 2011. Revidimi ishte i paraparë edhe me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (EPAP).

Një e arritur tjetër pozitive është finalizimi i ristrukturimit të PK-së. Një kujdes specifik i është kushtuar Departamentit kundër Krimit të Organizuar dhe Drejtoratit për Inteligjencë dhe Analiza, meqë roli i tyre do të jetë kyç për zbatimin e strategjisë për drejtimin e punëve policore në bazë të informacionit nga inteligjenca (DPI). EULEX-i, në një sinergji me Komisionin Evropian për përmirësimin e infrastrukturës së TI-së dhe krijimin e databazave të sigurta (përmes IPA 2010, të miratuar në dhjetor 2010), do të mbështes zhvillimin dhe zbatimin e konceptit të drejtimit të punëve policore në bazë të informacionit nga inteligjenca në gjithë Kosovën.

Në kontekst të ristrukturimit organizativ të PK-së, EULEX-i zyrtarisht ka këshilluar Ministrin e Punëve të Brendshme dhe DP të PK-së që të konsiderojë një numër të kërkesave esenciale. Këto kërkesa dalin nga nevoja për një konsolidim të mëtejshëm të strukturës së re të PK-së përmes zhvillimit të PSO, (në veçanti të atyre që lidhen me procedurat mbi zhvillimin e punës, bashkëpunimin dhe përgjegjësitë) e deri te një bashkëpunim më i mirë dhe me raporte të mira me Doganën e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Një përkushtim i vazhdueshëm nga ana e PK-së për themelimin e një **Njësie për Mbrojtjen e Dëshmitarëve**, të qëndrueshme, mbetet një prioritet strategjik i cili do të kontribuojë edhe më shumë në luftimin e krimit të organizuar.

Përveç kësaj, një **Studim për ndarjen e resurseve**, me qëllim të ekzaminimit të funksionalitetit të referencave, veçanërisht në lidhje me vëllimin e punës dhe ndarjen e personelit ishte mbështetur nga EULEX-i dhe ECLO. Në korrik 2011, e gjithë struktura e PK-së ishte shpallur e gatshme, duke filluar nga Drejtori i Përgjithshëm e deri te niveli i nënstacioneve.

Lidhur me **detyrat policore në komunitet**, në mënyrë të suksesshme ka filluar aplikimi i plotë i planeve vjetore të patrullimit dhe i aplikimit të formularëve të raportimit në të gjitha stacionet. Nga të arriturat tjera të regjistruara gjatë vitit të kaluar janë zhvillimi dhe aplikimi i strategjisë për

zvogëlimin e përgjithshëm të krimit dhe të disa krimeve kryesore, si dhe aplikimit të procedurave të përhershme operative me qëllim të përcaktimit të kategorive dhe regjistrimit të përkatësisë etnike të viktimës në raportet e PK për krime, që mundëson nxjerrjen e saktë të statistikave lidhur me krimet kundër grupeve jo shumicë.

Progres është shënuar edhe në **menaxhimin e përmirësuar të patrullave**, veçanërisht përmes përfshirjes së konsultave me forumet e komuniteteve lokale (Këshillat komunale për siguri në komunitete).

PK po ashtu i kontribuon Departamentit Special Anti-Korrupsion (PSRK-TFAK) në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK). Kapacitetet e PSRK-TFAK janë shtuar dhe i përmbushin 100% nevojat e PRK-TFAK për staf policor; efikasiteti në **hetimin e rasteve të korrupsionit** është ngritur me pesë ekipe hetimore dhe një ekip të inteligjencës i cili është themeluar në kuadër të njësisë dhe që rastet e ngarkuara i heton në mënyrë të pavarur; kapacitetet ishin shtuar përmes trajnimeve të përparuara në fushat specifike.

Drejtoria për Krime Ekonomike dhe Korrupsion (DKEK) e Policisë së Kosovës ende ka mungesë pajisjesh të duhura dhe ka nevojë për t'u forcuar por themelimi i saj mund të konsiderohet si një hap përpara. Progresi është i ngadalshëm por përfshinë: infrastrukturë të përmirësuar (zyra të reja, 40 kompjuterë dhe pajisje tjera); potencial të shtuar për të hetuar rastet e korrupsionit. Janë themeluar gjashtë task forca anti-korrupsion të nivelit rajonal dhe në përbërjen e tyre janë 13 prokurorë dhe 20 policë të DKEK, të cilët fillimisht do të hetojnë një numër të madh rastesh të vjetra që gjenden nëpër prokuroritë rajonale dhe më pas do të vazhdojnë me hetimin e rasteve të reja; përmirësojnë shkathtësitë përmes trajnimeve të përparuara në fushat specifike (prokurim publik, teknika për hetime financiare, hetime të aseteve me prejardhje kriminale, shpëlarje të parave).

Menaxhimi i Bashkëpunimit kufitar me shtetet fqinje kryesisht zhvillohet sipas mënyrës ad hoc, ndërsa

mungon struktura e qartë dhe kompetencat e deleguara për bashkëpunim në nivel rajonal dhe atë lokal, veçanërisht kur bëhet fjalë për trajtimin e incidenteve kufitare.

Komisioni Evropian është duke e pajisur Policinë Kufitare të Kosovës me pajisje të TI për të siguruar një qarkullim efektiv dhe efikas të personave që hyjnë dhe dalin prej Kosovës dhe njëherit për të siguruar kontrollimin e brezit të gjelbër dhe të kaltër të kufirit nga ana e Policisë Kufitare. Që nga fillimi i vitit 2011 janë bërë përmirësime, të cilat janë paraqitur më poshtë:

- 1) Sistemet e harduerit për MKS janë vendosur në të gjitha PVK dhe në qendrat komanduese rajonale;
- 2) Instalimi dhe konfigurimi i serverëve qendror dhe i sistemit bek ap (backup) për VKK (Komanda qendrore);
- 3) Sistemet e softuerit për MKS janë vendosur dhe konfiguruar në të gjitha VKK dhe në qendrat komanduese/rajonale;
- 4) Lidhja e rrjetit të PK me databazat (pasaportat, letërnjoftimet dhe regjistrimet e veturave) nga Agjencia Qendrore e Regjistrimit (AQR) është themeluar dhe bartja e të dhënave prej AQR në PK është testuar dhe implementuar në mënyrë të suksesshme.

Ministri i Punëve të Brendshme, së bashku me U.D. së Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të KE (ECLO) dhe Ndihmës drejtori i PKK, kanë inauguruar MKS më datën 5 gusht.

Në rrafshin e **drejtësisë** është shënuar progres në një numër të fushave. Kuvendi i Kosovës i ka miratuar katër ligje të reja: 1) Ligji për Gjykatat 2) Ligji për Prokurorinë e Shtetit 3) Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe 4) Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).

Themelimi dhe konsolidimi i **KGJK, KPK dhe i strukturës së re gjyqësore** përfshinë fazën e planifikimit (janar 2011 deri dhjetor 2011) dhe fazën e implementimit (janar 2012 deri dhjetor 2012). KGJK (për gjykata) dhe KPK (për prokuroritë) janë përgjegjëse për lehtësimin dhe implementimin e tranzicionit prej strukturës aktuale në strukturën e krijuar sipas ligjeve të reja (planet e veprimit dhe grupet punuese për shtyrjen përpara të implementimit të Ligjit për Gjykatat janë themeluar). Misioni për së afërmi është duke i monitoruar dhe këshilluar të dyja këshillat gjatë këtij procesi sfidues të ndërtimit.

Në kuptim të rezultateve në nivel të KGJK-së është miratuar një draft rregullore për **zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së**, ndërsa është iniciuar edhe procesi për rishikimin dhe përditësimin e rregullave dhe procedurave për sesionet e këshillit.

Një rregullore për **zgjedhjen dhe emërimin e gjykatësve** është miratuar në shkurt 2011 dhe këshilli është duke e bërë rekrutimin për 112 poste për gjykatës, për herë të parë pas përfundimit të procesit të lustrimit dhe të riemërimit që ishte udhëhequr nga ndërkombëtarët. Pagat e gjykatësve janë rritur duke krijuar kështu kushte për mbështetjen e pavarësisë së gjyqësorit.

Në shkurt 2011, KGJK ka hapur një faqe të re të internetit e cila përditësohet rregullisht në dy gjuhë zyrtare duke kontribuar kështu në rritjen e **transparencës** dhe sigurimin e informacionit me kohë për publikun.

Një **Strategji** (trevjeçare) **për zvogëlimin e numrit lëndëve të grumbulluara** është miratuar, ndërsa është formuar edhe një këshill konsultativ për të përcjellë dhe mbikëqyrë implementimin e strategjisë së themeluar.

Organet e mbikëqyrjes dhe kontrollit për gjykatës dhe prokurorë janë njësoj të rëndësishme kur bëhet fjalë për objektivin e forcimit të llogaridhënies të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Për këtë qëllim, në Këshillin Prokurorial të Kosovës është vendosur një këshilltar i EULEX-it, ndërsa aktivitetet e MMK janë duke u dizajnuar në përputhje me prioritetet e identifikuara, njëkohësisht duke ofruar këshilla për **vendosjen e njësive për hetime të brendshme** (si, Njësia për Performancën e Prokurorisë dhe Zyra e Prokurorit Disiplinues).

KGJK-së dhe KPK-së ende u mungojnë burimet dhe buxheti për të përcjellur në mënyrë të duhur reformën e gjyqësorit, ndërsa asistenca nga komuniteti i donatorëve do të vazhdojë të mbetet faktor kyç.

Gjykatësit e EULEX-it janë duke raportuar për një progres të prekshëm në miratimin e një **sistemi transparent të ndarjes së lëndëve** në pesë gjykata të qarkut dhe në tetëmbëdhjetë gjykata komunale. Një trend pozitiv është shënuar në themelimin e zyrave për informim publik nëpër gjykata komunale. Aktualisht, katër gjykata e kanë miratuar këtë model dhe zgjerimi drejt gjykatave të tjera do të monitorohet nga afër.

Kur bëhet fjalë për forcimin e gjyqësorit vendës dhe për pavarësinë e tij, raportet tregojnë se **kërcënimet kundër gjykatësve vendës** dhe përpjekjet për të ndërhyrë në marrjen e vendimeve janë ende duke e penguar sistemin.

Një sërë mangësish po ashtu ishin identifikuar lidhur me mënyrën e kryerjes së punëve për **lëndët penale dhe civile**.

Për rastet penale, mangësitë janë regjistruar gjatë procedimit nëpër gjykata (palët nuk janë thirrë si duhet, mungojnë vulat), ndërsa për masën e mbajtjes (shkelje e rregullës së “48 orëshit”, përdorimi jo i mjaftueshëm i masave alternative, arsyetimet e dobëta ligjore lidhur me dyshimet e bazuara).

Kur bëhet fjalë për lëndët civile është shënuar një **zvogëlim i lëndëve të grumbulluara** në tetë gjykata komunale nga gjithsej tetëmbëdhjetë. Përkundër këtij progresi, mangësi të natyrave të ndryshme janë regjistruar gjatë procedimit nëpër gjykata (mungojnë vulat, përdorimi i gabuar i vulave në aktgjytime, mosthirrja e palëve, mungesa e nënshkrimeve, mungesa e aktgjytimeve në dosje, vonesa gjatë dërgimit të lajmërimeve).



Regjistri i lëndëve ekzistuese të korrupsionit në ekipet e prokurorive ishte kompletuar, ndërsa janë dhënë edhe udhëzimet rreth prioritizimit të lëndëve.

Marrë në tërësi, zhvillimi i shërbimit të prokurorisë së shtetit në vitin 2010 e deri më tani ka qenë i vazhdueshëm dhe substancial, në saje të përpjekjeve të Kryeprokurorit shtetëror dhe Ministrisë të Drejtësisë.

Në nivel të **Ministrisë së Drejtësisë**, progresi është regjistruar në rrafshet e shumta.

Më 5 maj 2011, Ministri i Drejtësisë Divizionin për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar e ka ngritur në departament. Me strukturën e re të departamentit parashihen pozita të veçanta për mbrojtjen e të dhënave dhe rastet ndërkombëtare të kidnapimit të fëmijëve. Të gjitha pozitat e lira në këtë departament janë plotësuar me staf.

Departamenti për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar gjatë vitit 2010 ka përpunuar rreth 8700 kërkesa për bashkëpunim të ndërsjellë ligjor në përputhje me afatet dhe procedurat e parapara. Në muajt e fundit janë kryer **12 ekstradime**.

Marrëveshjet mbi ekstradimin, transferimin e personave të dënuar dhe mbi asistencën e ndërsjellë ligjore janë nënshkruar me IRJM dhe Turqinë. Bisedimet për përmbyllje të këtyre marrëveshjeve janë duke u zhvilluar me Kroacinë, Italinë, Bullgarinë, Gjermaninë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Një marrëveshje për transferim të personave të dënuar ishte nënshkruar edhe me Belgjikën.

Ligji për **asistencë të ndërsjellë ligjore për çështjet penale** është finalizuar. Më 01 qershor 2011 Ministria e Drejtësisë e ka dorëzuar këtë ligj në Qeveri për miratim.

Në fushën e shërbimeve **të forenzikës dhe të mjekësisë ligjore** EULEX-i ka regjistruar një nevojë urgjente për një program të ndërtimit të kapaciteteve. Ekspertët e EULEX-it për këtë fushë do të përqendrohen në aktivitetet e mentorimit, mirëpo rekomandohet edhe një mbështetje shtesë e donatorëve për iniciativat e ndërtimit të kapaciteteve.

Aktivitetet e MMK-së në **Shërbimin Korrektues të Kosovës** tregojnë se kontrollimi dhe ndërprerja e kontrabandës në burgun e Dubravës janë përmirësuar dukshëm. Është bërë miratimi dhe lansimi i një plani strategjik (2011-2015). Në kohën e raportimit nuk është regjistruar ndonjë rezultat domethënës, mirëpo shenjat e progresit priten të shihen gjatë raportimit të ardhshëm.

Çështjet për shqetësim mbeten të përqendruara në rrafshin e shërbimeve të prokurimit.

Në fushën e **doganës** progresi ishte shënuar në saje të **përmirësimit të komunikimit të brendshëm** ndërmjet drejtorisë për zbatimin e ligjit dhe drejtorisë për operim dhe të hyra. Miratimi i një mënyre të veprimit të bazuar në inteligjencë ka rezultuar në kryerjen e disa operacioneve të përbashkëta që kishin për cak prodhimin ilegal dhe distribuimin e alkoolit dhe kontrabandimin e cigareve.

Është shënuar një **bashkëpunim i intensifikuar me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit dhe prokurorët publik**. Është themeluar një njësi e përkushtuar për të bashkëpunuar me prokurorët publik, ndërsa në janar 2011 është miratuar edhe një MiM ndërmjet Prokurorisë Shtetërore dhe Doganës së Kosovës. Një shenjë e progresit ishte edhe vendosja e policëve të Kosovës në dhomën e operacioneve të doganës në kuadër të kornizës për aktivitetet që lidhen me Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Puna përgatitore për **ASYCUDA (Sistemi i Integruar Botëror për Përpunimin e të Dhënave Doganore) i përshtatur me BE-në** me Doganën e Kosovës është finalizuar me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe UNCTAD-it.

Është vendosur faza e parë e Sistemit për Shkëmbimin e të Dhënave Elektronike (SEED) të financuar nga komuniteti evropian në partneritet me IRJM, Shqipërinë dhe Malin e Zi, ndërsa priten të fillohet edhe me fazën e dytë. Kjo do të duhej të mbështes **implementimin e MIK**. Nevojiten përpjekje të mëtejme që kjo qendër e përbashkët operacionale të bëhet plotësisht funksionale.


Është shënuar progres edhe në nxitjen e DK që të veprojnë kundër shkeljes së të **Drejtave për Pronën Intelektuale (DPI)**. Tetë kompani ndërkombëtare tash janë regjistruar në Ministrinë për Tregti dhe Industri, duke e obliguar DK që të veprojnë në rast të zbulimit të mallrave të falsifikuara. Përgjigjet priten edhe nga kompanitë tjera të prekura nga kjo dukuri. Disa raste, duke përfshirë edhe një rast serioz lidhur me 3,000 palë këpuca sportive të


falsifikuara janë duke u zhvilluar hetimet.

DK ka miratuar ndryshimet e Udhëzimit Administrativ për **procedurat disiplinore** të cilat do të duhej ta përmirësojnë shqyrtimin e rasteve të pohuara për sjellje joprofesionale dhe të veprimeve të ndaluara nga DK. Njësia e Standardeve Profesionale është duke punuar në shtatë lëndë të cilat janë nga viti 2010 dhe deri në mars të vitit 2011 nuk kanë filluar të punojnë në lëndët e reja.

PJESA 2

DHJETOR 2008-KORRIK 2011
VLERËSIM I PROGRESIT





PIKËREFERIM

Që nga viti 2009, EULEX-i fuqimisht ka rekomanduar vendosjen e një databaze unike dhe të një platforme statistikore për Sistemin e Drejtësisë Penale (SDP). Ishte rekomanduar që Kosova të miratojë një format për statistikën e krimeve të miratuar nga të gjitha palët me interes për SDP (MD, MPB, PK dhe PP).

PIKËREFERIM

Vlerësimi i EULEX-it për vitin 2009 vëri në pah mangësitë e procedurave në PK për regjistrimin e përkatësisë etnike të viktimave të krimet ose kategorizimin e krimeve si të motivuara etnikisht⁵. Këto mangësi ndikojnë në kapacitetet e PK për t'u ballafaquar me krimet të cilat mund të jenë të motivuara etnikisht.

LUFTIMI I KRIMIT NË MËNYRË EFEKTIVE

Të dhënat e publikuara nuk ishin menjëherë të kuptueshme për publikun e gjerë dhe industrinë private dhe nuk përkonin me kategoritë e zakonshme që përdoren në BE². Për më tepër, statistikave të disponueshme të PK për krimin nuk ishin përdorur gjithmonë në mënyrë efektive për udhëheqjen e operacioneve të synuara policore³.

Me qëllim të krijimit të një praktike standarde për mbledhjen, regjistrimin dhe krahasimin e informacionit lidhur me krimin, PK është bërë partnere e një projekti⁴ që implementohet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime në kuadër të kornizës CARDS, që ka për qëllim zhvillimin dhe monitorimin e instrumenteve për agjencitë rajonale të zbatimit të ligjit. Objektivi i projektit është forcimi i reagimit ndaj krimin dhe korrupsionit në shtetet e Ballkanit Perëndimor duke paraqitur mekanizmat shtetëror për statistika në institucionet për drejtësi dhe punë të brendshme në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe *acquis* e BE-së (tërësinë e vlerave të komunitetit) dhe praktikave më të mira.

Në kuadër të kornizës së projektit, prej 25 – 27 maj në Mal të Zi ishte mbajtur një konferencë për statistikave të krimin. Përfaqësuesit e PK, MPB dhe PP kanë marrë pjesë në konferencë. Në fund të konferencës ishte diskutuar edhe drafti i dokumentit për statistikave të krimin.

Pas miratimit të politikave, një proces përmes fazave të konsultimit me palët e brendshme/jashtme të interesit do të shpie drejt marrëveshjes mbi modalitetet e implementimit, të cilat do të jenë nën monitorimin e EULEX-it. Luftimi i krimin nga PK ka përparuar në

drejtim të gjendjes së dëshiruar të llogaridhënies dhe multietnicitetit, përmes përgatitjes dhe zbatimit të PSO për regjistrimin, mbledhjen dhe krahasimin e të dhënave mbi përkatësinë etnike të viktimës së krimin dhe të rasteve të krimin të cilat mund të jenë të motivuara etnikisht.

PSO e detajuar përcakton kategoritë e përkatësisë etnike të viktimës për të gjitha format e krimin të regjistruar në Kosovë. Veç kësaj, një program trajnues

PIKËREFERIM

EULEX-i gjithnjë ka potencuar rëndësinë e shtimit të bashkëpunimit ndërmjet njësisve të PK për krime dhe prokurorive publike (PP), me qëllim të operimit si një Sistem i Unifikuar i Drejtësisë Penale (SUDP). Interaksioni i dobët ndërmjet dy institucioneve gjatë fazës së hetimit dhe në vazhdimin e punës në raste ka qenë objekt i raporteve të përgatitura nga shumë palë me interes.

për gjithë stafin relevant të PK të përfshirë në mbledhjen, krahasimin, nxjerrjen dhe analizën e të dhënave policore mbi incidentin kishte përfunduar (nën udhëheqjen e departamentit për trajnime të PK).

Ndonëse revidimi i Kodit të Procedurës Penale përcakton për një raport të ngushtë pune ndërmjet prokurorëve publik dhe hetuesve të PK⁶ mirëpo, dispozitat ligjore ende nuk janë duke u reflektuar në

praktikë. Provat e disponueshme tregojnë se kontaktet ndërmjet prokurorëve publik dhe hetuesve të PK janë minimale dhe shumë më të pakta për të gjeneruar rezultate të dëshiruara për hetimin e krimeve.

Kanalet jo të përshtatshme për komunikim dhe mungesa e databazave të përbashkëta ishin theksuar nga ana e EULEX-it⁷, OJQ-të⁸ dhe OSBE-ja⁹, si shkaktarë të nivelit të dobët të bashkëpunimit. Hetuesit e PK përmendin vështirësitë për të kontaktuar prokurorët dhe marrjen e informacionit për rastet. Mungesa e informacionit kthyes për rastet të cilat i referohen prokurorisë ishte konfirmuar edhe gjatë projektit të monitorimit të gjykatave¹⁰ nga ana e BIRN-it në vitin 2009.

Për të përmirësuar këtë gjendje, EULEX-i ka iniciuar një numër objektivash gjithëpërfshirës me qëllim të përmirësimit të mundësive organizative të SDP. Qëllimi i fundit ishte krijimi i ndjenjës se hetuesit policorë dhe prokurorët në mënyrë të përbashkët i takojnë SDP, të cilët bashkërisht ndajnë përgjegjësinë për suksesin apo edhe dështimin e SDP.

Përkundër përpjekjeve gjatë dy viteve të fundit nuk është arritur ndonjë progres i madh. Në të vërtetë, të gjitha këto objektiva aktualisht janë shënjuar si “në

PIKËREFERIM

Një nga lëshimet e vërejtura nga EULEX-i në vitin 2009 ishte mungesa e një qendre të vetme (administrative dhe operacionale) për sistemin e inteligjencës kriminale¹². Pengesat në shkëmbimin e inteligjencës ndërmjet strukturave të ndryshme të PK po ashtu ishin vërtetuar nga organizatat tjera vendëse dhe ndërkombëtare¹³. Ky deficit ishte drejtpërdrejt i lidhur me performancën e dobët të PK gjatë hetimeve dhe mundësisë për të pasur si qëllim grupet e krimit të organizuar.

pritje të vendimeve të politikave”¹¹.



KP and EULEX joint patrols

EULEX-i konfirmon progresin e arritur për krijimin e një ‘qelize për analizë të burimeve të hapura; themelimi i zyrës ndërlidhëse dhe integrimi i rajonal i njësisë të inteligjencës në gjithë strukturën e DPB¹⁴. OSBE ka pasur një rol kyç në “trajnimin e trajnerëve për inteligjencë kriminale dhe analizë” për stafin e DPB/NJRI.

Shtirja e inteligjencës kriminale në PK mbetet një parakusht kritik për kryerjen e hetimeve proaktive dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit¹⁵.

PIKËREFERIM

Që nga viti 2009 EULEX-i ka avokuar fuqishëm për një polici të udhëhequr në bazë të inteligjencës për t’u bërë një prioritet nga më të rëndësishmit për komandantët e lartë policorë gjatë tre vjetëve të ardhshëm¹⁶. Prandaj, EULEX-i ka bërë mentorimin dhe këshillimin e stafit përkatës të PK gjatë implementimit të plotë të programit për përfshirjen e inteligjencës si bazë për kryerjen e detyrave policore në gjithë organizatën. Ky sistem është në bazë të strategjisë proaktive për luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, korrupsionin dhe krimin ndërkufitar.

Me qëllim të adresimit të këtyre mangësive, stafi i lartë i PK nga sektori për krime ka sajuar një plan, objektivi kryesor i të cilit është zhvillimi i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Analiza (DIA) si një qendër për Sistemin e Inteligjencës Kriminale të PK.

Mungesa e planifikimit strategjik në PK dhe përdorimi i inteligjencës për qëllime të policisë ishin vërejtur në vitin 2008 dhe 2009 përmes raportimeve të ndryshme vendëse¹⁷ dhe ndërkombëtare¹⁸.

Sektori për kufi i PK po ashtu do të jetë një pjesë aktive e sistemit të unifikuar të inteligjencës në PK, duke e pajisur atë me të dhëna dhe duke nxjerrë informacion prej këtij sistemi. Policia kufitare e PK posedon me potencial për t'u bërë një komponentë e rëndësishme e sistemit të inteligjencës, meqenëse të dhënat për lëvizjet e individëve dhe të automjeteve në kufijtë e Kosovës janë esenciale për luftimin e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar¹⁹.

Meqë implementimi i plotë i projektit për kryerjen e detyrave policore në bazë të inteligjencës ende nuk ka përfunduar, EULEX-i ka vërejtur një përkushtim të ri të menaxhmentit të lartë të PK për një implementim sa më të shpejtë të këtij koncepti. Krahasuar me progresin e dobët në vitin 2010, organizimi në PK tani po dëshmohet dhe po jep shenja se është duke e zhvilluar një kulturë të mbledhjes së informacionit inteligjent, që ka qenë edhe rekomandim i EULEX-it në vitin 2009.

Raportet e EULEX-it për Progresin qysh në fillim të vitit 2011 tregojnë se PK është plotësisht e angazhuar në projekt dhe se tani po ndiqen objektivat si vijon:

- 1 Përfshirja e PUI në gjithë organizimin e PK (me ndihmën e OSBE-së).
- 2 Përmirësim në kulturën e mbledhjes së informacionit inteligjent në PK.
- 3 Themelimi i një cikli unik inteligjent brenda PK.

Puna vazhdon në një numër detyrash në ndjekje të dy objektivave të para, duke përfshirë:

- (a) sigurimin që PK të ketë PSO adekuate për mbledhje të informacionit si dhe përdorimin dhe zhvillimin e inteligjencës në të gjitha sektorët, departamentet, rajonet dhe njësitë e PK-së;



EULEX integrated police unit members

sektorët, departamentet, rajonet dhe njësitë e PK-së; (b) organizimin e sesioneve të vetëdijesimit mbi PUI në të gjitha shtyllat, departamentet, drejtoritë, rajonet dhe njësitë; (c) përgatitjen e një pakoje për trajnim të zyrtarëve të lartë policorë sipas praktikave më të mira evropiane, duke mos u kufizuar vetëm në procesin e vendimmarrjes nga PUI; dhe (d) krijimin e standardeve për mbledhjen e të dhënave, ruajtjen, vlerësimin, klasifikimin, krahasimin, analizën dhe shpërndarjen e tyre sipas standardeve evropiane.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, në kuadër të IPA 2010, ka shpallur një kontratë furnizimi për përmirësimin e infrastrukturës së TI në PK, veçanërisht për:

a) Përmirësimin e Sistemit informatik të PK, i cili përmban module mbi incidentet, tiketat e trafikut, dokumentet e humbura, aksidentet në komunikacion, personat e kërkuar, armët, pronat dhe një modul për kërkim të përparuar dhe harta digjitale. Funkcionalitetet e këtyre moduleve duhet të jenë të përshtatura me legjislacionin e zbatueshëm dhe të mbështesin ndryshimet strukturore të Policisë së Kosovës;

b) Përmirësimin e Sistemit të inteligjencës kriminale që paraqet një bazë të inteligjencës për përdorimin e të gjitha të dhënave të lidhura me inteligjencën kriminale. Ky sistem përdoret për të përmirësuar bashkëpunimin ndërsektorial në mbledhjen, krahasimin, vlerësimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave të inteligjencës kriminale.

c) trajnimi i stafit të PK për përdorimin e sistemeve të përparuara.

Ky projekt pritet të startojë nga fundi i vitit 2011 dhe do të adresojë sfidat e PUI nga këndvështrimi i TI duke siguruar një komponentë të ndërtimit të kapaciteteve përmes trajnimit. Implementimi i projektit si dhe

duke pasur burime adekuate për luftimin e këtyre dukurive në mënyrë sistematike. Do të vendoset edhe një sistem i qëndrueshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, sikurse edhe një infrastrukturë ligjore dhe institucionale²⁴.

PIKËREFERIM

EULEX-i në fillim të vitit 2009 ka vërejtur se PK ka mbajtur standardet e larta në sigurimin e përputhjes me ligjin dhe Rregulloren për politika dhe procedura (RrPP). Pavarësisht, stafi i lartë komandues i PK nuk ka arrit të ketë një strategji të qartë ose dokumente me shkrim mbi politikën, në mënyrë që nxisin një qasje më proaktive në hetimin e krimeve, veçanërisht në fushën e luftimit të krimit të organizuar²⁰.

Infrastruktura ligjore dhe institucionale, padyshim se do t'i kontribuojë racionalizimit dhe modernizimit të aktiviteteve policore në PK. Në korrik të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka hartuar një numër dokumentesh strategjike dhe plane të rëndësishme veprimi me qëllim të parandalimit dhe të luftimit të krimit të organizuar²¹: për shembull, Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të organizuar (2009-2012)²² i Qeverisë së Kosovës, ka krijuar një bazë për Draft-Strategjinë për përparimin e Drejtorisë për krimin e organizuar (DKO), e cila ishte finalizuar nga stafi i lartë i sektorit të PK për krime bashkë me planin e vet të implementimit. Kjo e arritur ishte vlerësuar pozitivisht në Raportin e Progresit për Kosovën nga KE për vitin 2009²³. Strategjia duhet të udhëheq DKO drejt një qasjeje më pozitive në hetimin e krimit të organizuar. Progres i mëtejshëm ishte arritur edhe me korrigjimin e strukturës organizative të DKO në PK.

Suksesi në luftimin e shtimit të grupeve kriminale dhe shpërbërja e strukturave të tyre varet nga një numër faktorësh kritik, duke filluar nga përmirësimi i bashkërendimit me gjithë sektorët në PK e deri te shkëmbimi dhe përdorimi i inteligjencës kriminale dhe

Stafi i DKO në PK ka sajuar një plan implementimi që kërkon paraqitjen e një strategjie të përbashkët për hetimin e krimeve të drogës. Strategjia përfshinë një trajtim më efektiv të hetimeve, mbledhjen e informacionit, bashkërendimin dhe bashkëpunimin me pikat kontaktuese rajonale dhe ndërkombëtare.

Strategjia e PK ishte zhvilluar me sukses në gusht të vitit 2010. Ajo përvijon një qasje proaktive për hetimin e krimeve të drogës në pajtim me Strategjinë kombëtare anti-drogë²⁶ dhe Planin e veprimit 2009 - 2012²⁷. Ky implementim është duke vazhduar në gjithë organizatën. Plani parasheh monitorimin e strategjisë së implementuar dhe shfrytëzimin e saj në gjithë PK, në radhë të parë në autoritetin e narkotikëve.

Statistikat e fundit për konfiskim të narkotikëve nga PK tregojnë për një rritje të aftësive të PK për të mbledhur informacion dhe për të vepruar në saje të inteligjencës. Mirëpo, siç edhe ka theksuar Ministri i Punëve të Brendshme në muajin maj 2011, gjatë takimit të një grupi punues ndërinstitucional për implementimin e Strategjisë anti-drogë, në këtë drejtim ende shumë mbetet për t'u punuar.²⁸

PIKËREFERIM

Kapaciteti i PK për të luftuar krimin e lidhur me drogën po ashtu i është nënshtruar një shqyrtimi të kujdesshëm nga EULEX-i në vitin 2009²⁵. Kjo ka rezultuar me vërejtjen e mungesës së një strategjie gjithëpërfshirëse për t'u ballafaquar me krimet e lidhura me drogën: PK kishte nevojë të zhvillonte një qasje më të integruar për këtë çështje, të përmirësojë marrjen me rastet dhe bashkërendimin e qarkullimit të informacionit brenda Drejtorisë për krimin e organizuar dhe njësitë rajonale të PK për hetime të narkotikëve (NJRHN). Bashkërendimi i dobët me aktorët si PKK dhe Dogana e Kosovës (KC) gjithashtu ishte regjistruar: PK dhe DK janë institucionet e linjës së parë për luftimin e aktiviteteve të paligjshme, kjo për shkak të rolit që kanë në kontrollimin e kufirit të Kosovës dhe në parandalimin e tregtisë së paligjshme. Prandaj, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i tyre është qenësor për forcimin e kontrollit për aktivitetet e paligjshme të cilat prekin shëndetin publik dhe sigurinë në Kosovë.

SIGURIMI I KUFIJËVE

Brenda kornizës së Policisë së Kosovës, Policia Kufitare e Kosovës është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e vendkalimeve kufitare (VK) si dhe menaxhimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e brezit kufitar të kaltër dhe të gjelbër²⁹.

Policia kufitare e Kosovës (PKK) është njëri prej pesë sektorëve dhe është e organizuar në nivel qendror, rajonal dhe atë lokal. Procesi i ristrukturimit të PK, i përfunduar në mars 2011, përfshinte edhe departamentet kufitare relevante. Progresi i mirë është arritur në nivelin qendror me shkriren e dy departamenteve për vëzhgimin e kufirit dhe për kontrollin e kufirit në një departament të vetëm, si dhe me themelimin e Departamentit për menaxhimin e integruar të kufirit (MIK).

Themelimi i Departamentit për MIK siguron një drejtim strategjik për PKK drejt arritjes së objektivave të përcaktuara me Strategjinë e Kosovës për MIK dhe Planin e veprimit³⁰. Një lajmërim i tillë i mundësoi menaxhmentit të lartë në PK që në bashkëpunim me stafin e EULEX-it dhe palët tjera me interes nga MPB dhe KFOR-i të planifikojnë një pranim gradual të përgjegjësive

PIKËREFERIM

Në vitin 2009, PK u ballafaqua me pranimin e përgjegjësive për sigurimin e brezit të gjelbër të kufirit të Kosovës³¹. Kjo përgjegjësi u paraqit si rezultat i lajmërimit nga NATO-ja për reduktimin e trupave të KFOR-it në Kosovë. Ky vendim mundësoi një ushtrim të "lirimit" gradual të prezencës së KFOR-it nga kufiri i Kosovës në fillim të vitit 2010.

të vëzhgimit të brezit të gjelbër kufitar nga KFOR-i tek PKK.

PKK dhe EULEX-i janë pajtuar për një plan afatshkurtër, të njohur si 'Harta' në mars 2010. Harta përvijon katër faza të transferimit, të bazuara në vendimet e Komisionit për demarkacion dhe përfshinë objektivat dhe aktivitetet e parapara me Strategjinë e Kosovës për MIK³² dhe Planin e veprimit 2009-2012; Tutje ai

përmban një vlerësim themelor të burimeve të nevojshme teknike dhe njerëzore.

Deri në ditët e sotme, progresi është regjistruar gjatë gjithë bartjes së përgjegjësive për vëzhgimin e brezit të gjelbër të kufirit me Republikën e Shqipërisë³³ dhe IRJM.


Procesi do të përmbyllet me bartjen e përgjegjësive për vëzhgimin e brezit të gjelbër të kufirit³⁴ edhe me Malin e Zi³⁵ dhe Serbinë³⁶. Lidhur me shtetin e parë, bartja e mundshme e përgjegjësive është gjatë muajve shtator-tetor 2011³⁷. Mirëpo, të dhënat e sakta për mënyrën se si duhet të finalizohet ky proces mund të lidhen me çështjen e pazgjidhur të demarkacionit të kufirit me shtetin e Malit të Zi³⁸. Përkitazi me kufirin me Serbinë, çfarëdo zhvillimi do të varet nga rrethanat politike dhe për këtë arsye nuk ka ndonjë datë të përcaktuar për bartje të detyrave.

PIKËREFERIM

EULEX-i që nga viti 2009 ka nënvizuar rëndësinë e përmirësimit të shkathtësive të PK për planifikim³⁹. Për menaxherët dhe mbikëqyrësit e PKK u konstatua se nuk kishin një qasje standarde kur bëhej fjalë për planifikim dhe vlerësim. Kjo pati një efekt negativ në aftësitë e Policisë kufitare për luftimin e 'krimeve ndër-kufitare'.



Vizitë e Shefit të misionit në një vendkalim kufitar.



Passport control at the Pristina Airport

PK ka sajuar një plan për shtimin e kapaciteteve të planifikimit, duke përfshirë zhvillimin e hollësishëm të Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për plane të dokumenteve dhe për raporte të vlerësimit. PSO ishte finalizuar në maj 2010⁴⁰.

PSO⁴¹ do të ndihmojnë organizimin dhe strukturën e punës së PK dhe luftimin e formave të ndryshme të krimit⁴². Për më tepër, PSO është një instrument i cili i mundëson PKK të planifikojë, ekzekutojë dhe të marrë informacion për operacionet e kryera në mënyrë të unifikuar dhe profesionale.

Për të siguruar implementimin dhe funksionalitetin e PSO në fjalë është kryer një ushtrim i përbashkët monitorues

në terren nga PK dhe stafi i EULEX-it prej muajit tetor deri në dhjetor 2010. Monitorimi ka shpalosur nevojën për një trajnim të vazhdueshëm.

Pajisjet e Policisë kufitare dhe infrastruktura ishin vlerësuar si jo të përshtatshme në vitin 2008⁴³, me një vërejtje të veçantë për hapësirat që ishin vënë në dispozicion për intervistimin e imigrantëve të ndaluar. PKK ka miratuar një plan afatmesëm për përmirësimin e kësaj situate. Plani ka për qëllim përcaktimin e standardeve minimale të nevojshme në të gjitha hapësirat për ndalimin e imigrantëve. Standardet janë shpërndarë në të gjitha pikat e vendkalimeve kufitare (PVV). Renovimi i qelive për mbajtje është duke vazhduar. Ndonëse vërehet një shkallë e progresit, ndërtesat ende nuk mund të krahasohen me këto standarde.

Progres është arritur në dizajnimin dhe trajnimet e reja specifike për stafin e ndalimit, siç parashihet me këtë plan.

PATRULLIMI EFIKAS DHE SIGURIMI I RENDIT PUBLIK

Edhe pse është vlerësuar së PK-ja ka kryer funksionet e veta publike në nivel të kënaqshëm gjatë viteve 2008 dhe 2009⁴⁴ EULEX-i ka vërejtur së ekziston nevoja për të përmirësuar menaxhimin e aktiviteteve të rregullta të patrullimit në PK duke e përshtatur punën e patrullave më nevojat e komunitetit lokal. Llogaridhënia e PK-së në nivelin lokal kërkon forcim të kapaciteteve udhëheqëse, trajnime të mëtejme dhe një motivim të shtuar në mesin e mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë dhe policëve patrullues.

Stafi komandues i operacioneve të PK-së ka pranuar se ekziston nevoja e rritjes së kompetencave të mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë duke e bërë këtë si prioritet për tri vitet e ardhshme, duke e zhvilluar një plan për rritjen e shkathtësive bazë të patrullimit. Qëllimi i përgjithshëm ishte rritja e disiplinës në mesin e policëve patrullues, ngritja e motivimit tyre duke e ngritur vetëdijesimin mbi rëndësinë e punës së strukturuar gjatë patrullimit, si dhe rritja e efikasitetit në të gjitha format rutinore të patrullimit për t'i plotësuar pritjet e komunitetit.

PIKËREFERIM

Vlerësimi i EULEX-it gjatë vitit 2009 ka sinjalizuar për mungesën e planifikimit të patrullave si përgjigje ndaj problemeve policore të gjetura. Në përgjithësi, EULEX-i ka gjetur së policët patrullues udhëzoheshin pak ose fare nga mbikëqyrësit dhe tendenca ishte që organizimi i patrullave të lihej në gjykimin e lirë të policëve patrullues⁴⁵.

Plani parashihte përpilimin e një PSO mbi Menaxhimin e Patrullave duke përfshirë udhëzimet për turne, përdorimin proaktiv të inteligjencës lokale dhe asaj gjithë kosovare, vërja në shënjestër e çështjeve policore me interes lokal, patrullat e dirigjuara, patrullat monitoruese; një program me kurse trajnime i bazuar në PSO e lartcekur që do të rriste njohuritë dhe shkathtësitë e mbikëqyrësve të patrullave; në raportin final do të paraqes implementimin e PSO gjithandëj Kosovës dhe të një sistemi udhëhequr nga PK-ja për monitorimin e rezultateve të mbikëqyrësve.



Deri me tani, rezultatet kanë qenë në përputhje me objektivat e pritura. PSO-ja për Menaxhimin e Patrullave ishte përpiluar dhe miratuar nga zinxhiri komandues.

Programi i kurseve të trajnimit është dizajnuar. PK ka mbajtur një trajnim për trajnerë për të gjithë përfaqësuesit e rajoneve, të cilët do t'u mbajnë trajnime të gjithë mbikëqyrësve nëpër rajonet e tyre duke përfshirë Policinë e kufirit të PK në veri, perëndim dhe lindje⁴⁶. Implementimi dhe monitorimi i PSO-së ka filluar në maj 2011.

Në korrik të vitit 2009, Qeveria e Kosovës ka lëshuar një sërë dokumentesh strategjike dhe plane të duhura për veprim (2009-2012) më qëllim të parandalimit dhe luftimit

PIKËREFERIM

Analiza krahasimtare e EULEX-it në periudhën nga 2006 deri në 2009 ka treguar së niveli i shënuar i krimit në Kosovë, duke përfshirë krimet e rënda siç janë vrasjet, ka qenë më i larti në tërë rajonin⁴⁷. EULEX-i po ashtu ka vlerësuar së PK i mungon një sistem i rëndomtë i treguesve kyç për zbulimin e krimit. Përveç kësaj, gjatë viteve 2008 dhe 2009 nuk kishte dëshmi për lëshim të ndonjë udhëzimi strategjik nga ana e MPB-së mbi implementimin e një strategjie për parandalimin e krimit⁴⁸.

të krimit⁴⁹. Prandaj, reduktimi i krimit në Kosovë, posaçërisht i atij në kategorinë e krimit të organizuar dhe korrupsionit, është shndërruar në një objektivi mbizotërues për stafin komandues që nga shtatori 2009⁵⁰.

Objektivi është që Strategjia e Qeverisë për Parandalimin e Krimit⁵¹ të integrohet në kuadër të detyrave të përditshme të stafit të lartë në PK në nivel të Drejtorisë, Rajoneve dhe Stacioneve. Për përmbushjen e këtij plani, në shtator të vitit 2010 PK ka aprovuar një Politikë me shkrim⁵², PK-ja po ashtu ka nxjerrë edhe një udhëzim për stafin e lartë në PK për të përcjellë këto parime të themeluara. Ndërmjet tetorit 2010 dhe shkurtit 2011, një ekip i përbashkët PK/EULEX ka kryer një sondazh në të gjitha rajonet dhe stacionet për të verifikuar se a po implementohet kjo politikë. Aktiviteti monitorues zbuloi së të gjitha nivelet e PK po e zbatonin politiken e shkruar.

KP-ja ka qenë e suksesshme në futjen e Strategjisë për Reduktimin e Krimit në tërë organizatën. Ekzistojnë veglat për përcjelljen e treguesve të krimit po ashtu edhe direktivat për përfshirjen e Komisioneve Komunale⁵³ dhe Lokale⁵⁴ për siguri.

PIKËREFERIM

EULEX-i gjatë vitit 2009 vlerësoi së shumë komandantë të stacioneve nuk po vepronin në përputhje me kërkesat ligjore⁵⁵ për konsultim dhe planifikim me komunitetin. Disa komandantë nuk po përpilonin plane vjetore të cilat në shënjestër do të kishin prioritetet dhe shqetësimet e komunitetit, që janë zbuluar me anë konsultimeve të rregullta.



EULEX Police HQ

Më qëllim të luftimit të këtij problemi, stafi i operacioneve në PK ka miratuar një plan si përgjigje ndaj nevojave policore në komunitet. Planet kanë për qëllim t'i udhëzojnë komandantët e stacioneve dhe menaxherët e drejtpërdrejtë për të çuar aktivitetet policore drejt adresimit të problemeve në komunitet, parandalimit të krimit dhe zgjidhjes së problemeve, që nënkupton përdorimin e planeve ditore që janë dhënë nga menaxherët e drejtpërdrejtë dhe plotësimin e formularëve për raportim nga ana e atyre policëve patrullues.

Sa i përket nismës për Siguri Strategjike në Komunitet në nivel të Ministrisë⁵⁶, një nismë nga Departamenti për Siguri Publike – i cili momentalisht është në zhvillim dhe mbështetet nga OSBE dhe ICITAP-i, do të udhëzojë dhe mbikëqyrë fuqizimin e Këshillave Komunal për Siguri në Komunitet (KKSK) si dhe grupeve të tjera konsultuese nga komuniteti lokal, të cilat janë pjesë e një programi më të gjerë për zhvillimin e policisë në komunitet në tërë Kosovën. Kjo ngre nevojën e miratimit të një Strategjie pesëvjeçare (2011 – 2015) për sigurinë e komuniteteve.

Kur është fjala për rendin publik, EULEX-i ka vërejtur se PK-ja ka shënuar përparim të mirë me përpilimin dhe miratimin e konceptit të ri për Kontrollimin e Turmave dhe Trazirave në tetor 2010. Ky koncepti i unifikuar, i shtjelluar në një 'Manual Taktik të KKT-së', përbën një model vendor që është në përputhje me standardet e pranuaru ndërkombëtarisht.

Përparim i mëtejshëm është shënuar edhe sa i përket përpilimit të procedurave të cilat parashohin autorizimet, organizatën, detyrat dhe përgjegjësitë e NJMO-së gjatë angazhimeve të saj në operacione specifike, siç është kontrollimi i turmave dhe trazirave, sigurimi i mbledhjeve publike, arrestimi dhe kapja e personave të kërkuar nga gjykata, si dhe aktivitete të tjera mbështetëse policore.

PIKËREFERIM

Në vitin 2009, menaxherët e PK kishin informacion të kufizuar në lidhje me shfrytëzimin operativ dhe zbarkimin e Njesisë Speciale për Intervenim (NJSI) dhe Njesisë kundër armëve eksplozive të improvizuara (NJAEI). Njësitet në fjalë nuk ishin në gjendje të japin të dhëna statistikore të detajuara lidhur numrin dhe llojin e incidenteve në të cilat ata kishin marrë pjesë, duke shfaqur kështu një mungesë të llogaridhënies.

Për ta rregulluar këtë çështje, stafi i PK-së për operacione ka planifikuar një sistem për regjistrimin dhe kategorizimin e të gjitha incidenteve që kërkonin intervenimin e NJSI-së dhe NJAEI-së⁵⁷. Këto të dhëna ishin përdorur për të përmirësuar planifikimin e burimeve dhe për të vlerësuar performancën. Është zhvilluar një manual (në letër), sistem për regjistrimin e incidenteve në të cilat kërkohej intervenimi i NJSI-së dhe NJAEI-së, së bashku me një procedurë për vlerësimin e performancës së NJSI-së dhe NJAEI-së.

Është zhvilluar një ushtrim monitorues për të verifikuar përdorimin e sistemit në mënyrë që të konfirmohet përputhshmëria e tij e plotë.

Zbrazëtira e vetme e mbetur është ngritja e një njësie tërësisht funksionale kundër mjeteve eksplozive të improvizuara (NJMEI). PK ka sajuar një plan i cili ka për qëllim (a) transformimin e NJAEI-së në një NJMEI funksionale e cila do të vepronte në tërë Kosovën; (b) themelimin e një Qendre Intuitive me të dhëna mbi bombat dhe (c) themelimin e një sistemi administrativ të TI-së për të menaxhuar burimet e NJMEI-së. NJMEI-ja e PK është e aftë për të kryer operacione kundër MEI-vë në tërë Kosovën. Është me rëndësi të theksohen disa rekomandime të EULEX-it të dhëna si rezultat i raportit final të monitorimit të planit të përbashkët. Mes tjerash, aty përfshihet: (a) nevoja e përcaktimit të qartë të përgjegjësisë në mes të PK-së dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) meqë ata janë të kyçur në incidentet ku përfshihen eksplozivë, dhe (b) nevoja për të përmirësuar objektet e trajnimit të NJMEI-së së PK në kampin 'Vrellë'. Kjo do t'ju ndihmojë operatorëve të NJMEI-së së PK që të mos kenë ndonjë problem ricertifikimi në të ardhmen.

PIKËREFERIM

Në vitin 2009, EULEX-i ka vërejtur se Komandantët e PK-së kishin informacion të kufizuar në lidhje me gatishmërinë/zbarkimin e stafit operativ. Komandantët e kishin të pamundur të përcjellin trendet e shkëputjes së stafit dhe ndikimit të tyre në aftësinë operative, ndoshta për shkak të nënvlerësimit të mekanizmit të saktë për përcjelljen e burimeve në dispozicion. Prandaj, si rezultat i rekomandimit nga EULEX-i u zhvillua një sistem që përcjell të gjitha intervenimet e policëve patrullues, duke ia mundur PK të përdor ato të dhëna që të planifikojë burimet dhe të vlerësojnë efikasitetin.

Plani i përbashkët ka caktuar një agjendë ambicioze që fokusohet në katër qëllime kryesore a) themelimin e një sistemi funksionues për regjistrimin e incidenteve, që do të rregullohet me një PSO dhe do të jetë i aplikueshëm në tërë organizatën⁵⁸; b) krijimin e një programi specifik të

trajnimet për të gjithë stafin e duhur në KP të përfshirë në mbledhjen, krahasimin, korrigjimin dhe



Kosovo Police

analizimin e të dhënave policore mbi incidentet; c) krijimin e një PSO, një doracak dhe një programi për trajnimin e stafit të lartë në PK, (komandantëve në nivel të rajonit dhe stacioneve) ku të dhënat e mbledhura përmes këtij sistemi do të përdoren për planifikimin e burimeve dhe vlerësimin e performancës, dhe d) monitorim në kohëzgjatje prej 18 muajsh të përputhshmërisë me këtë PSO⁵⁹. Deri me tani, përparimi në përmbushjen e këtyre qëllimeve ka qenë i ngadalshëm. PK-ja ende është duke punuar në krijimin e një liste ditore të personelit në detyrë si dhe të një PSO për nivelet e stacioneve, rajoneve dhe Drejtorisë së Përgjithshme.

PIKËRFERIM

Një fushë tjetër që EULEX-i e kishte nën vëzhgim në vitin 2009 ishte njësia e trafikut në PK. Është gjetur se shumë propozime, udhëzime dhe kërkesa për ndryshime organizative në njësinë e trafikut në KP kishin dështuar që të arrijnë efektin e dëshiruar, si rezultat i një zinxhiri komandues të çrregullt dhe mungesës së shkathtësive në mesin e mbikëqyrëseve dhe menaxherëve për t'i implementuar ato. Është gjetur se shumë policë të trafikut kishin nevojë për trajnime thelbësore sepse kishin dështuar të veprojnë drejt arritjes së një strategjie të përbashkët të PK mbi trafikun rrugor.

Stafi komandues i njësisë së trafikut në PK është duke punuar për të arritur ndryshimet e dëshirueshme në strukturën organizative të Drejtorisë së Trafikut, duke u munduar të arrijnë një komunikim të avancuar, udhëheqësi strategjike dhe komandë funksionale. Puna është përqendruar në zbatimin e Procedurës së re për Operim Standard gjatë Trajnimit⁶⁰, ngritjen e kapaciteteve për policët e trafikut në strukturat dhe procedurat e rishikuara operative e gjithashtu edhe miratimin e praktikave më të mira Evropiane dhe standardeve të pranuarua ndërkombëtarisht për policinë e trafikut.

Përparimi në këtë aspekt ka qenë i ngadalshëm. Atëherë kur operacionet të jenë në një shkallë më të avancuar, do të behët një vlerësim i strukturës së re organizative të njësisë së trafikut në KP, i PSO së Trafikut dhe i PSO së Trajnimit.



KP in Prizren

SIGURIMI I NJË ORGANIZATE TË QËNDRUESHME

Menaxhmenti i burimeve në KP përbehet nga Personeli dhe Departamenti për Trajnime si dhe Departamenti për Shërbime Mbështetëse. Sa i përket sektorëve të tjerë, funksionet e menaxhimit të burimeve menaxhohen dhe drejtohen nga Baza Qendrore e PK – Në kuadër të këtyre dy departamenteve përfshihet një numër i personelit dhe një sërë shërbimesh administrative e mbështetëse.

Departamenti për Shërbime Mbështetëse udhëheq shumë funksione mbështetëse teknike që janë vendimtare për qëndrueshmërinë e PK. Ai përfshinë pesë drejtori që merren me funksione administrative që janë thelbësore, veçanërisht me: buxhet dhe financa, prokurim, logjistikë, objekte, dhe Teknologji Informative dhe Komunikimin (TIK).

PIKËREFERIM

Në vitin 2009, EULEX-i ka monitoruar planifikimin e buxhetit dhe procesin e ekzekutimit. Përderisa planifikimi financiar është parë të jetë në përputhshmëri të plotë me ligjin (Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie⁶¹) dhe udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), në pah dolën kapacitetet e kufizuara për planifikim shumëvjeçar. Stafit kyç i mungonin zotësitë e nevojshme për menaxhimin e kërkesave buxhetore dhe shpenzimeve. Trendi i shpenzimeve gjatë vitit fiskal ka evidencuar një shtim të shpenzimeve për çerekun e fundit, gjë që tregon për keqmenaxhim të fondeve/apo planifikim të dobët⁶². Të dhënat e EULEX-it zbuluan së ndarjet e buxhetit nganjëherë udhëhiqeshin nga prioritetet e menaxherëve, e jo në bazë të qëllimeve strategjike të PK-së.

Këto mangësi kanë bindur menaxherët në PK që janë në kuadër të Departamentit për Shërbime Publike që të vendosin një plan që ka për qëllim përmirësimin e administrimit të buxhetit të PK. Qëllimi i planit ishte të dizajnojë një program që ka për qëllim përmirësimin e administrimit të buxhetit dhe financave. Kjo po ashtu do të përfshinte zhvillimin e një strategjie afatgjatë, projekteve shumë vjeçare, duke marrë parasysh përparësitë e duhura

që rrjedhin nga nevoja e decentralizimit dhe trajnimit të menaxherëve përgjegjës për kërkesa buxhetore dhe shpenzime në PK.

Pas tri vitesh, u dizajnuar programi, u zhvilluan strategjia dhe projektet afatgjate, po ashtu u kompletua



rishikimi i dobive që rrjedhin nga decentralizimi; u caktua gjithashtu edhe plan programi për trajnimin menaxherëve financiar në PK. Në mënyrë që të përmirësohet administrimi i buxhetit dhe financave, Drejtori për Buxhet dhe Financa në PK ka përgatitur dhe shpërndarë formularët standardë nëpër rajone të cilët do të përdoren për menaxhimin e qarkullimit të parasë së gatshme, projekteve kapitale, shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera, po ashtu janë shpërndarë edhe formularët mujor, katër mujor, gjashtë mujor dhe vjetor për raportimin shpenzimeve.



PIKËREFERIM

Siç është vlerësuar edhe nga EULEX-i në vitin 2009 transparencja është një nga kërkesat më të rëndësishme të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP), prandaj në menaxhmentin e PK-së ka vend për përmirësim.⁶³ Edhe pse është gjetur se legjislacioni ishte në përputhje me parimet bazë të BE-së në fushën e prokurimit, implementimi i tij u konsiderua të jetë nën standardet e praktikave më të mira të BE-së. Dëshmitë kanë treguar për një strukturë të brendshme të prokurimit e cila është e dobët, e cila përbehej nga vetëm një jurist dhe disa asistentë që merreshin me tenderë specifik. Përformanca e PK gjatë veprimeve të prokurimit ishte e papërshtatshme, duke ndikuar kështu në programet e investimeve kapitale për objekte dhe infrastrukturë.

EULEX-i në këtë fushë ka vërejtur një përparim të kufizuar. Puna do të vazhdojë me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara: (a) ngritja e një menaxhmenti institucional të prokurimit, që do të jetë në përputhje me parimet praktikave më të mira Evropiane, llogaridhënia ndaj publikut, transparencja, qëndrueshmëria organizative, ligji i aplikueshëm, plani strategjik i PK-së dhe buxheti i Kosovës⁶⁴; (b) futja e procedurave për planifikim afatshkurtër në pajtim me ligjin e aplikueshëm dhe planin për buxhet të PK-së dhe (c) përpilimi i një raporti monitorues mbi zhvillimet në këto dy fusha.

Dy objektivat e para do të përmbushen gjatë vitit 2011. EULEX-i konsideron se zhvillimi i kapaciteteve të prokurimit në PK është i një rëndësie të madhe, dhe do të vazhdojë me vlerësimin e përparimit në këtë fushë.

PIKËREFERIM

Rishikimi i kryer nga EULEX-i gjatë 2009, vuri në pah nevojën për standarde më të mira në menaxhimin e autoparkut⁶⁵. Sistemi i menaxhimit duhet të racionalizohet, dhe të vendosen strategji për përmirësimin e efikasitetit gjatë prokurimit. Është vërejtur së Drejtoria për Logjistikë, përgjegjëse për menaxhimin e autoparkut të PK, ka hasur në vështirësi gjatë mirëmbajtjes së këtij autoparku i cili ka 1,521 automjete (ku përfshihen 63 modele të ndryshme).

Kundërmasat e miratuara në shtator 2009 kishin për qëllim zhvillimin e një sistemi për menaxhimin e parkut të automjeteve duke përfshirë menaxhimin e buxhetit, prokurimin, menaxhimin e ciklit jetësor, mirëmbajtjen dhe riparimin. Ky sistem është projektuar, ndërsa PK momentalisht është duke i analizuar procedurat përkatëse.

PIKËREFERIM

EULEX-i gjatë vitit 2009 ka vlerësuar se PK-ja gjithnjë ka dështuar në realizimin e projekteve të investimeve kapitale si rezultat i planifikimit të dobët të buxhetit. Vija buxhetore më e qëndrueshme, 'Investimet Kapitale', kishte përqindjen më të ulët të shfrytëzimit vetëm 8% nga fondet e ndara për një çerek, që tregon për një planifikim shumë të dobët të investimeve për vitin 2009⁶⁶. Prandaj, lehtë mund të merreshin me mënd pasojat mbi standardet e pasurive në PK si dhe në vet performancën e PK-së.

Me qëllim të ngritjes së performancës gjatë shpenzimeve kapitale, PK-ja ka filluar një rishikim të shpenzimeve për investime kapitale. Studimi kishte për qëllim të identifikoj shkaqet e performancës së dobët dhe të caktoj mjetet potenciale për ndreqjen e tyre. Në kohën kur po shkruajmë, studimi gati se ka përfunduar.

PIKËREFERIM

Sistemi PK për gradim ka qenë subjekt i masave reformuese që nga vitit 2009. Ndryshimet ishin të nevojshme në mënyrë që të rritej transparencën e sistemit dhe të sigurohen kritere më të mira të meritokracisë⁶⁷.

Është paraqitur një sistem i ri i gradimit. Drejtori i Përgjithshëm i PK në bashkëpunim me ICITAP, ka përpiluar dhe miratuar një Procedurë Standarde të Operimit. Kjo PSO është në fuqi që nga prilli i vitit 2011 dhe do të jetë në dispozicion për qasje në faqen e PK në internet. Është me rendësi të ceket se ky sistem i ri është duke u prezantuar në të gjitha rajonet.

Është i nevojshëm monitorimi i procedurave të gradimit të cilat janë korrigjuar rishtazi. Vendimi për të rinisur gradimet e pezulluara për më shumë se dy vite qëndron para DP i



cili së pari duhet t'i përmbyll korrigjimet e strukturës së gradimit në PK. Në qershor të vitit 2011, PK tregoi se ky proces do të mund të kompletohej para tetorit.

Teknologjia Informative dhe Komunikuese (TIK) përfaqëson një funksion kritik për një organizatë policore moderne dhe efikase. Në të kaluarën, zhvillimi i qëndrueshëm i TI-së dhe përdorimi efikas i bazës së të dhënave është dëshmuar të jetë i vështirë për PK-në, posaçërisht sa i përket kapaciteteve njerëzore. Deri më tani, PK përfundimisht ka ngritur një komponentë të qëndrueshme të TI.



PIKËREFERIM

Siç ka vërejtur EULEX-i në vitin 2009, PK nuk kishte mundësi që ta ruaj stafin e vet të TI-së dhe bazës së të dhënave kryesisht për shkak të pagave më konkurruese në sektorin privat. Nga 63 pozita të ndara me buxhet për TI/Komunikim, 23 (36%) prej tyre si staf i trajnuar dhe me përvojë po e lëshonin punën në këtë organizatë⁶⁸. Si pasojë, organizata u desh të mbështetej në ndihmë teknike nga jashtë organizatës⁶⁹.

Stafi i lartë i PK ka zhvilluar me sukses një strategji për rekrutim, trajnim dhe ç'është më e rëndësishmja, mbajtjen e një stafi vendor të specialistëve për TI/Komunikim në mënyrë që t'i jap fund varësisë nga specialistët e huaj⁷⁰. PK ka shkuar edhe me tej rekomandimit origjinal dhe tani është duke i përpiluar kompetencat e përgjithshme për stafin e TI, njëkohësisht PK po e zgjeron edhe fushën e shërbimeve të

TI të cilat do të ofrohen.

Një ekspert i Komisionit Evropian nga TAIEX është vendosur në Kosovë me kërkesë të menaxhmentit të PK, për t'i ndihmuar PK në avancimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK). Eksperti i TAIEX-it për TI, në bashkëpunim me drejtorin e PK për TI, kanë përpiluar një plan strategjik pesë vjeçar (2011 – 2015) për një sistem të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit, duke ju qasur çështjeve që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë e TI/Bazës së të dhënave dhe SIPK (baza e të dhënave të Policisë). Kjo strategji është në përputhje me planin strategjik të PK 2011-2015⁷¹. Kjo fushë konsiderohet si prioritet në kornizën e punës policore të bazuar në inteligjencë.





Justice **CU**

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS DHE GJYKATËSIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është përgjegjës për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor. Ai po ashtu ka për qëllim ngritjen e një gjyqësori që reflekton natyrën shumetnike të Kosovës dhe që vepron në përputhje me parimet e barazisë gjinore. KGJK-ja gëzon autoritetin ekskluziv për transferimin e gjykatësve, marrjen e masave disiplinore dhe shkarkim e tyre.

Administrimi i gjykatave po ashtu është nën autoritetin e KGJK-së, i cili është përgjegjës për nxjerrjen e rregulloreve, përpilimin e rregullave të brendshme, ristrukturimin organizativ, dhe mbikëqyrjen⁷².

Siç theksohet në planin strategjik 2007 -2012, KGJK-ja ka një agjendë ambicioze. EULEX-i ka inkurajuar përshtetimin e ritmit për implementimin e këtij plani, duke filluar me caktimin e prioritetit të objektivave⁷³. Ky ka qenë qëllimi i bashkëpunimit mes KGJK-së dhe EULEX-it, i cili u përqendrua tek pavarësia dhe llogaridhënia, qasja ndaj menaxhmentit dhe ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë mbështetjen ndaj implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve (SML) të sponsorizuar nga Komisioni Evropian⁷⁴.

PIKËREFERIM

Që nga viti 2009, EULEX-i ka theksuar nevojën për caktimin e kushteve zyrtare për pavarësinë e gjyqësorit dhe autonominë e prokurorisë. De jure pavarësia e paraparë me legjislacionin e Kosovës do të duhej të përkthehej në veprimet e përditshme të gjyqësorit dhe prokurorisë.

Pavarësia de facto nënkupton që gjykatësit janë shërbyes civil profesional. Standardet më të larta të integritetit dhe trajnimit janë kërkesa thelbësore për një sistem gjyqësor të pavarur dhe llogaridhënës. Niveli i llogaridhënies duhet të sigurohet me standarde të pranuar ligjore dhe profesionale⁷⁵.



Organi i Këshillit të KGJK-së është funksionalizuar në një përbërje të përkohshme në mesin e gushtit 2009; fillimisht përbëhej nga juristë Kosovar (3 anëtar) dhe gjykatës ndërkombëtar (2 anëtar), mirëpo me asnjë gjykatës apo prokuror kosovar. Pritja për emërimin e anëtarëve nga Gjykata Supreme ndikoi në aftësinë funksionale të Këshillit.

Autoriteti i Këshillit për të rekrutuar gjykatës dhe prokuror i ishte dhënë përkohësisht Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP)⁷⁶.

KPGJP⁷⁷ ishte themeluar “më qëllim të kryerjes së një shqyrtimi të vetëm, gjithëpërfshirës, në tërë Kosovën sa i përket përshtatshmërisë së të gjithë konkurrentëve për emërimet të përhershme (...) siç janë gjykatësit dhe prokurorët në Kosovë.” KPGJP-ja ishte financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e SHBA-ve. Institucioni i KPGJP-së përfytyronte një Komision vërtetë të pavarur, të lirë nga ndikimi politik apo ndikimet tjera të jashtme. Rregullat e procedurës dhe metodologjitë e punës të miratuara nga ky Komision e mundësuan përmbushjen e objektivave.⁷⁸

Procesi i emërimeve ishte organizuar në tri faza të njëpasnjëshme: faza I – përzgjedhja e gjykatësve për Gjykatën Supreme, dhe prokurorëve për Zyrat e Prokurorisë së Shtetit dhe Prokurorisë Speciale; faza II – përzgjedhja e gjykatësve për gjykatat e qarkut, Gjykatën Ekonomike, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, dhe Prokurorëve të Qarkut; dhe faza III – përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve komunal.

334 gjykatësit dhe prokurorët e emëruar ishin vlerësuar me kujdes, duke mundësuar kështu përzgjedhjen e kandidatit më të kualifikuar për secilën pozitë. Gjashtëdhjetë përqind (60%) e pozitave ishin plotësuar nga anëtarë të rinj⁷⁹. Me përmbylljen e fazës së tretë KPGJP-ja organizoi një provim të etikës, në mënyrë që të identifikoj kandidatë të tjerë të përshtatshëm për pozitat e mbetura.

KGJK-ja mori përgjegjësinë për rekrutimin, verifikimin dhe përzgjedhjen e stafit gjyqësor pasi të këtë mbaruar procesi i verifikimit dhe emërimit. Përderisa Këshilli po i jep formën sistemit duke u bazuar në udhëzimet dhe procedurat e KPGJP-së,⁸⁰ EULEX-i vazhdon ta monitoroj përputhshmërinë e rezultateve të KGJK-së me praktikat më të mira evropiane.

Në shkurt të vitit 2010, dy gjykatësit e sapoemëruar nga Gjykata Supreme dhe një prokuror nga PSRK-ja ju bashkëngjitën organit të Këshillit. Këshilli zgjodhi si kryetar një gjykatës të Gjykatës Supreme. Kur më në fund këshilli u plotësua nga tre anëtarët e rinj të gjyqësorit, hapi i parë që ai bëri ishte miratimi i doracakut për menaxhimin e gjykatave.

Në shkurt të vitit 2011, KGJK-ja miratoi një rregullore mbi emërimin e gjykatësve dhe publikoi shpalljet për 112 pozita. Meqë ishte hera e parë për KGJK-në që po bënte përzgjedhjen e kandidatëve për pozita gjyqësore, Këshilli do të garantoj që procesi të jetë i bazuar në dispozitën ligjore përkatëse dhe të jetë në pajtim me parimet e transparencës dhe drejtësisë. Në prill të vitit 2011 KGJK-ja miratoi një rregullore për përzgjedhjen e gjykatësve nga vet kolegët e tyre. Pesë gjykatës do të zgjedhen si anëtarë të KGJK-së nga kolegët e tyre, dy nga Gjykata

Supreme, nga një nga gjykatat e shkallës së dytë dhe nga një nga gjykatat e shkallës së parë. Rregullorja garanton proces të drejtë të propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së me anë të fletëvotimit sekret. Më tej, ajo ka për qëllim të drejtoj KGJK-në drejt një qasje të integruar dhe të orientuar nga shërbimi kur është fjala për gjykatat, si dhe të përfshijë gjykatësit në procesin e vendimmarrjes së këshillit KGJK-së⁸¹.

Në korrik të vitit 2011, pas miratimit të rregullores, KGJK-ja organizoi zgjedhjet e para në tërë Kosovën, gjatë të cilave gjykatësit e shkallës së parë zgjedhën në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me anë të fletëvotimeve sekrete dy anëtarë të cilët do të jenë përfaqësuesit e tyre në KGJK. Gjykatësit nga gjykatat e shkallës së parë – gjykatat komunale, gjykatat komunale për kundërvajtje si dhe Gjykata Ekonomike në Prishtinë – ishin gjykatat me të drejtë vote. Kandidatët ishin propozuar nga kolegjiomet e gjykatave në fjalë të cilat ishin mbajtur ndërmjet 23 dhe 27 majit 2011. Gjykatësit e EULEX-it kanë monitoruar këto zgjedhje dhe kanë raportuar se procesi në përgjithësi kishte rrjedhur mirë në të pesë vendvotimet (gjykatat e qarkut).

Kuvendi ende ka për të emëruar anëtarët gjyqësorë dhe ligjorë në KGJK ashtu siç ceket në ligj. KGJK-ja u pajtua që t'i drejtohet komisionit përgjegjës në Kuvendin e Kosovës para së të filloj ky proces, dhe t'ia paraqes një listë të kandidatëve të mundshëm për anëtarësim në KGJK. Kjo çështje ka një rëndësi shumë të madhe për pavarësinë e gjyqësorit, për arsye se në vendet që janë në tranzicion Këshillat Gjyqësor shpesh shërbejnë si porta hyrëse që politika i përdor për të ndikuar në gjyqësor. Pjesëmarrja e këshillit në përzgjedhjen e gjykatësve që do të bëhet nga ana e Kuvendit do të ishte shenjë e maturisë politike për Kosovën dhe, në rast të një marrëveshjeje të tillë, EULEX-i do të verifikoj se a është marrë parasysh kontributi i gjyqësorit gjatë procedurave të përzgjedhjes. EULEX-i do të vazhdojë të monitoroj për së afërmi dinamikën e këtij propozimi i cili do të shpie drejtë një rregulloreje gjithëpërfshirëse e cila do të disiplinoj funksionimin e Këshillit.

Ndërhyrja politike në riemërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ende konsiderohet si një rrezik i prekshëm.

Ende nuk është arritur balancimi ndëretnik prandaj KGJK-ja duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një përfaqësim të drejtë të pakicave, në pajtim me ligjin. Me keqardhje, nuk është raportuar asnjë ndryshim sa i përket përbërjes së gjyqësorit të vendosur në veri të Kosovës.

Lëndët e pazgjidhura paraqesin një nga sfidat kryesore për Gjyqësorin Kosovar⁸². KGJK-ja ka themeluar një grup punues përgjegjës për përpilimin e një strategjie për zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura (Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Lëndëve të Pazgjidhura), e miratuar në nëntor të vitit 2010 së bashku me emërimin e koordinatorit kombëtar. Strategjia parasheh një listë të veprimeve të natyrave të ndryshme në nivelin legjislativ, rregullues dhe atë funksional. Në mars të vitit 2011 KGJK-ja ka themeluar Komisionin Konsultativ që të ndihmoj në implementimin e strategjisë për lëndët e pazgjidhura, si dhe pritjet të siguroj rrjedhën e duhur të informacionit nga gjykatat tek Bordi Kombëtar për Zvogëlimin e Lëndëve të Pazgjidhura.

Është shënuar përparim i prekshëm⁸³ në kornizën ligjore, me miratimin e një numri të ligjeve të reja që definojnë më tej "infrastrukturën" gjyqësore të Kosovës (Ligji mbi Gjykatat⁸⁴, Ligji mbi Këshillin Gjyqësor⁸⁵, Ligji mbi Prokurorin e Shtetit⁸⁶, dhe Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës⁸⁷).

Plani i veprimit për implementimin e Ligjit mbi Gjykatat, i konsideruar si gurthemel i reformës gjyqësore, parasheh një kornizë kohore 2011-2013⁸⁸. KGJK-ja dhe kryesuesi i saj janë përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm ku një grup punues do ta shoqëroj procesin. Grupi punues takohet rregullisht dhe përfshin një gjykatës të EULEX-it. Kryetarët e gjykatave janë ende përgjegjës që të sigurojnë një sistem për caktimin të lëndëve në mënyrë transparente

PIKËREFERIM

Në vitin 2009 EULEX-i ka rekomanduar funksionalizimin e Zyrës së Komisionit Disiplinor brenda KGJK-së.

dhe objektive deri në kohën kur të hyjë në fuqi Ligji mbi Gjykatat.

Sot, shumica e pozitave të lira Zyrën e Komisionit Disiplinor (ZKD) janë duke u plotësuar⁸⁹. Transferimi i ZKD-së nga Ministria e Drejtësisë në KGJK në gjysmën e dytë të vitit 2009 ka shënuar një hap pozitiv përpara

drejt sigurimit të pavarësisë dhe fshehtësisë gjatë gjykimit të rasteve disiplinore. Rritja e llogaridhënies së KGJK-së dhe Komisionit të saj është pranuar edhe nga Raporti i Progresit i KE-së 2010⁹⁰ dhe nga Mekanizmi Përcjellës i EULEX-it për MMK⁹¹. Përfundimi procesit të verifikimit dhe emërimit në vitin 2010 ka kontribuar në zvogëlimin e lëndëve disiplinore të pazgjidhura,

PIKËREFERIM

Që nga viti 2009 EULEX-i ka nënvizuar mungesën e sistemi për vlerësimin e përmbushjes së detyrave brenda gjyqësorit në Kosovë. Vlerësimet kanë zbuluar se procedurat e rekrutimit dhe gradimit nuk ishin objektive dhe transparente, dhe ka shtyrë KGJK-në që të zhvilloj dispozita të detajuara për rekrutim dhe gradim⁹².

funksionim më të mirë të Komisionit si dhe krijimin e një vetëbesimi më të lartë në mesin e gjyqësorit vendor. KGJK-ja ka themeluar grupet punuese të cilat kanë prodhuar draft Rregulloren për Normat Orientuese dhe draft Rregulloren për Stimulim. Këto mjete janë pjesë e

PIKËREFERIM

Raporti i EULEX-it për Programe i vitit 2009 ka raportuar se numri i gjykatës[ve për 100.000 banorë në Kosovë është më i vogël sesa ai në shtetet përreth apo shtetet Evropiane⁹³, gjë e cila shtyri drejt rekomandimit të KGJK-së për të monitoruar kushtet e punës për gjykatësit dhe prokurorët kosovar dhe për të përcjellë për së afërmi procesin e rekrutimit tyre⁹⁴.

përpjekjeve për të ngritur një sistem të vlerësimit të gjykatësve bazuar në performancën e tyre. Sipas zyrës për statistika, gjatë vitit 2009 në Gjyqësorin kosovar janë punësuar 269 gjykatës, një mesatare prej 14.19 gjykatës për çdo 100.000 banorë, përderisa në Shërbimin Prokurorial në Kosovë ishin duke shërbyer 89 prokurorë, që i bie 3.7 prokurorë për çdo 100.000 banorë. Edhe pas kompletimit të procesit të verifikimit dhe riemërimit nga KPGJP-ja, numri i gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë ende është i pamjaftueshëm. Nga 461 pozita gjyqësore të shpallura janë plotësuar vetëm 334, ndërsa 127 pozita mbesin ende të lira⁹⁵. Disa OJQ kanë krahasuar shifrat me vendet tjera në

rajon⁹⁶

dhe kanë sinjalizuar për një rënie të numrit të prokurorëve (nga 88 në 78) pas procesit të verifikimit dhe riemërimit në vitin 2010, si dhe për numrin më të vogël rekord prej 12.41 gjykatës për çdo 100,000 banorë. Trendet e rënies shpjegohen gjithashtu nga situata demografike në vitin 2009, ku moshë mesatare për 269 gjykatësit kosovar ishte 54 ndërsa për Prokurorët 60⁹⁸.

Shpallja e 112 pozitave gjyqësore nga KGJK-ja pritet ta rrisë numrin e gjykatësve dhe prokurorëve, duke e përfruar Kosovën me standardet e rajonit. Gjithashtu, procesi i verifikimit dhe riemërimit, si efekt anësor, kishte zvogëlimin e moshës mesatare të të emëruarve në 50.⁹⁹

EULEX-i po ashtu ka vlerësuar për një pamjaftueshmëri në integrimin e pakicave dhe gjinisë femërore si pjesë e stafit gjyqësor në Kosovë dhe kështu i ka rekomanduar KGJK-në, KPK-në, dhe kryetarët e gjykatave që ta përmirësojnë pozitën e pakicave në Sistemin e Drejtësisë në Kosovë dhe të implementojnë politika të fuqishme për barazi gjinore. Aktualisht, janë plotësuar vetëm një e treta e vendeve gjyqësore të dedikuara për komunitetet jo shumicë, përderisa 28% e stafit të emëruar janë femra, prej të cilave disa janë në pozita menaxhuese.

PIKËREFERIM

EULEX-i ka vërejtur së raportet e lëshuara nga Njësia Gjyqësore për Auditim¹⁰⁴ as nuk janë shqyrtuar, e as nuk janë aprovuar nga KGJK-ja deri në vitin 2009, duke dështuar kështu në përfshirjen e rekomandimeve të dala në raportet e auditimit nga menaxhimi i përditshëm i gjyqësorit¹⁰⁵.

Që nga viti 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka bërë



An outline of the new Justice Building project funded by the European Commission
përmirësime të konsiderueshme¹⁰⁰, posaçërisht me nisjen e 'Programit të Vazhdueshëm'¹⁰¹ dhe 'Programit Fillestar'¹⁰². Procesi i fundit i verifikimit dhe shpallja e 112 pozitave gjyqësore nënkupton trajnim të mëtejshëm për gjykatësit dhe prokurorët e rinj dhe kërkon nga KGJK-ja të zhvillojë një strategji për trajnime të vazhdueshme¹⁰³.

Pas emërimit të Drejtorit të Sekretariatit në prill të vitit 2010, KGJK-ja në qershor të të njëjtit vit shqyrtoi dhe miratoi raportin e NGJA-së për vitin 2009 dhe planin e punës së NGJA-së për vitin 2010¹⁰⁶.

Gjithashtu ka nisur procesi i rishikimit të organizimit të brendshëm në KGJK, menaxhimit të seancave të këshillit

dhe zbatimit të vendimeve. Kryesuesi i KGJK-së ka formuar një grup teknik i cili ka për detyrë të përgatis draft rregullore për këto çështje.

GJYKATËSIT

Gjykatësit e EULEX-it nga lëmi civil dhe penal në Gjykatën e Qarkut kanë raportuar për një nivel të lartë bashkëpunimi me homologët e tyre kosovar¹⁰⁷ që nga nisja e operacioneve. EULEX-i ka monitoruar, mentoruar dhe këshilluar gjykatësit vendor në organizmin e gjykatave, forcimin e gjyqësorit kosovar, si dhe në lëndët penale e civile.

Aktivitetet për monitorimin e organizimit të gjykatave kanë vërejtur disa dobësi në funksionimin e përditshëm të gjykatave në Kosovë, ndër të cilat janë: mungesa e sistemit të rotacionit i cili siguron një dispozicion të vazhdueshëm në sportelin e pritjes nëpër gjykata; mungesa e theksuar e Gazetës Zyrtare nëpër gjykata, gjë e cila vështirëson punën e gjykatësve¹⁰⁸; vështirësi për t'u qasur në Gazetën Zyrtare online për shkak të problemeve me lidhjen e internetit; praktika e aplikimit e të ashtuquajturës "Kërkesë për pjesëmarrje në seancën kryesore të shqyrtimit" nga ana publikut të interesuar për përcjelljen e një gjykimi, kjo kërkesë duhet të parashtrohet disa ditë para seancës gjyqësore dhe është subjekt i aprovimit nga ana e kryetarit të gjykatës¹⁰⁹

(kjo gjë nuk është në përputhje me legjislacionin e Kosovës,¹¹⁰ e as më praktikën më të mira të BE-së dhe të drejtave ndërkombëtare njerëzore¹¹¹); mungesa e vulës në aktgjykime apo përdorimi i vulës së gabuar; mungesa e emrit të gjykatësit përgjegjës në regjistrin kryesor; mos ftesa e palëve përbën dukuri që paraqitet rregullisht. Më tej, EULEX-i ka vlerësuar se zakoni i qytetarëve për të diskutuar me Kryetarin e Gjykatës apo gjykatësit tjerë mbi rastet që janë në vijim është në kundërshtim të qartë me nocionin e një shqyrtimi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. EULEX-i i ka mbështetur gjykatat për të hapur pika informuese në kuadër të gjykatave ku qytetarët do të mund t'i adresonin kërkesat e tyre pa diskutuar rastet që janë në vijim me gjykatësit kosovar. Në gjykatat komunale të Gjakovës, Vitisë, Ferizajt, Lipjanit, Rahovecit, Malishevës dhe Skenderajt janë hapur Zyra për Informimin e Publikut.



PIKËREFERIM

Në vitin 2009 Sistemi Informues për Menaxhimin e Lëndëve nuk ishte futur në kuadër të veprimeve të përditshme të gjykatave dhe prokurorive të Kosovës. SIML-ja nuk ishte në përdorim ndoshta për shkak se kompjuterët nuk përputheshin me programin.

Problemet me lidhje dhe nevoja për trajnime të mëtejme vazhdojnë të jenë pengesë për implementimin e plotë të sistemit. Si rezultat, futja e Sistemit Informues për Menaxhimin e Lëndëve nëpër gjykata po ecën me një ritëm jo të njëjtë. KGJK-ja duhet t'ju jap gjykatave një afat përfundimtar për të vënë SIML-në në funksion në mënyrë efektive në gjithë Kosovën. EULEX-i ua bëri me dije

PIKËREFERIM

Në vitin 2009 EULEX- ka vërejtur dobësi serioze tek gjykatat e qarkut dhe prokuroritë e qarkut në aplikimin e një sistemi objektiv dhe transparent të caktimit të lëndëve¹¹³.

KGJK-së, KPK-së, gjykatësve dhe prokurorëve kosovarë nevojën për të pasur një sistem objektiv dhe transparent të caktimit të lëndëve, duke përfshirë mekanizmat që parandalojnë keqpërdorimet gjatë caktimit të lëndëve. Është miratuar një plan i përbashkët për realizimin e një

PIKËREFERIM

EULEX-i ka vlerësuar infrastrukturën në dispozicion të gjykatësve në nivel të gjykatave të qarkut si të pamjaftueshme dhe ka ngritur shqetësime sa i përket qasjes në drejtësi, ku përmenden gjykimet e mbajtura nëpër zyra, ku pjesëmarrja e publikut është e pamundshme.

SCL që shmang keqpërdorimet në ndarjen e lëndëve¹¹⁴.

EULEX-i konsideron se sistemi për caktimin e lëndëve në masë të madhe e ka arritur qëllimin e vet, parimet e SCL-së janë bërë publike nëpër disa gjykata. Caktimi i lëndëve do të monitorohet vazhdimisht në të gjitha gjykatat.

Disa nga mangësitë e theksuara përfshijnë mungesën e hapësirës adekuate për punë për gjykatësit dhe prokurorët kosovarë; në gjykatat e qarkut ka mungesë të gjykatoreve, mungesë të hapësirave të sigurta për ruajtjen

e dosjeve si dhe mungesë të dhomave të sigurta për depozitim, si rrjedhojë, EULEX-i ka këshilluar KGJK-në që të zhvilloj politika me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe infrastrukturës në Gjyqësorin kosovar¹¹⁶. KGJK-ja ka treguar gatishmëri që të merret më këtë çështje. Një numër i projekteve për ndërtim/renovim të gjykatave janë përfshirë në kuadër të buxhetit 2012-2014, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e Ligjit mbi Gjykatat. Për shkak të shkurtimeve buxhetore, KGJK-ja njëkohësisht bazohet edhe në donatorë ndërkombëtar për financimin e projekteve kapitale, siç është projekti i renovimit të gjykatave i mbështetur nga USAID-i, pastaj projekti i furnizimeve kyçe (p.sh. me kompjuterë, me gjeneratorë dhe gjëra të tjera të ngjashme) i mbështetur nga Ambasada Mbretërore e Norvegjisë. KGJK-ja kohëve të fundit ka ngritur një komision auditues për të mbikëqyrur dhe për të dhënë udhëzime strategjike mbi financat, buxhetin dhe zyrat e prokurimit, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është sigurimi i përputhshmërisë me ligjin, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Kjo gjë pritet ta përmirësoj shërbimin ndaj gjykatave. Masat e ndërmarra për sigurinë e gjykatësve dhe prokurorëve kosovarë mbesin të dobëta. Praktika e përhapur për t'ju drejtuar gjykatësve dhe prokurorëve kosovarë në mënyrë të drejtpërdrejtë pa aspak maturi vazhdon të jetë një shqetësim. Gjykatësit dhe prokurorët punojnë nën presion të vazhdueshëm dhe janë subjekt i kërcënimeve si brenda ashtu edhe jashtë ndërtësës së gjykatës¹¹⁷. Gjykatësit e EULEX-it kanë raportuar për disa incidente në rajonin e Pejës ku njerëzit futeshin në zyrat e gjykatësve, të paftuar dhe pa u penguar nga sigurimi. Kjo situatë i shtyn të gjithë ata që të hezitojnë të merren më rastet e ndjeshme, posaçërisht me ato që ndërlidhen më krimet e luftës¹¹⁸. KIPRED-i konsideron së mungesa e masave institucionale për mbrojtjen e gjykatësve dhe prokurorëve i pengon ata që t'i zbatojnë dispozitat për konfiskimin e pasurive¹¹⁹. BIRN-i ka zbuluar se nuk është shënuar asnjë përparim në rastet e sulmeve ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, kryesisht e të cilave mbeten të paidentifikuar; gjithashtu, pas sulmit apo kërcënimit, të këtyre zyrtarëve nuk u janë siguruar masat e duhura të sigurisë, derisa autoritetet kompetente nuk reagojnë fare¹²⁰

Siç kanë cekur raportet monitoruese të OSBE-së, policët u kanë ofruar siguri gjykatësve dhe prokurorëve vetëm në rastet ku përfshiheshin të pandehurit e mbajtur në paraburgim, apo gjatë gjyqimeve të mbajtura nëpër gjykatore me prani të publikut¹²¹. Kjo nuk është vetëm çështje e mbrojtjes së individëve të përfshirë në aktivitete gjyqësore; pas kësaj çështje qëndron edhe një kontekst institucional. Pritet që "[a] gjykatësi gjatë gjithë kohës të sillet në një mënyrë të tillë e cila ngrit besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit", siç edhe kërkohet nga Kodi i Etikës¹²²; gjykatësit duhet të gëzojnë të drejtën e çdo lehtësie e cila u mundëson atyre t'i përmbushin detyrat në mënyrën e duhur.

Prandaj, për ta forcuar gjyqësorin kosovar EULEX-i ka theksuar rëndësinë për të pasur një bashkëpunim më efikas me Policinë e Kosovës duke planifikuar bashkërisht masa të sigurisë që janë më të devotshme, dhe që do të aplikohen edhe pas orarit të punës dhe jashtë gjykatave¹²³.

Pavarësisht gatishmërisë së KGJK-ës për të përmirësuar standardet e sigurisë, janë raportuar shkurtime buxhetore. Megjithatë, kjo nuk do të duhej ta pengonte KGJK-në që t'i aplikoj në tërësi masat mbrojtëse, si për stafin ashtu edhe për ndërtesat.

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS DHE PROKURORËT

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) është një institucion i pavarur i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me Kushtetutë¹²⁴ dhe në bazë të Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës¹²⁵. KPK-ja ka për detyrë që të siguroj qasje të njëjtë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të sigurohet se prokurorët po e kryejnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme. KPK-ja do të sigurohet se prokurorët e shtetit do të pasqyrojnë natyrën shumë-etnike të Kosovës dhe se parimet e barazisë gjinore do të përmbushen. Më tej, KPK-ja është përgjegjëse për rekrutimin, trajnimin, masat disiplinore, dhe menaxhimin e brendshëm financiar.

Siç është e përcaktuar me Ligjin mbi KPK-në¹²⁶ përbërja fillestare e këtij këshilli do të jetë si në vijim:

- Kryeprokurori i Shtetit;
- Një Prokuror (ish anëtar i KGJK-së)
- Një Prokuror Special që shërben në Këshillin Gjyqësor të Kosovës;


– Ministri i Drejtësisë;

– Një Prokuror i Qarkut dhe një Prokuror Komunal të zgjedhur nga anëtarët e lartcekur,

– Tre (3) anëtarë të tjerë të zgjedhur nga këshilli siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 5 të ligjit në fjalë.

Këshilli i KPK-së është themeluar në prill të vitit 2011 dhe të gjithë anëtarët janë zgjedhur. Anëtarët e këshillit kanë zgjedhur Zëvendës Kryeprokurorin e PSRK-së si Zëvendës Kryetar të KPK-së.

Detyrat dhe kompetencat përkatëse të cilat deri më tani janë ushtruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë janë transferuar tek KPK-ja, janë nënshkruar Memorandume të Mirëkuptimit mes KPK-së dhe MD-së dhe mes KPK-së dhe KGJK-së. KPK-ja ka miratuar rregullat për komisionin e saj disiplinor, dhe ka zgjedhur anëtarët e tij. KPK-ja ka miratuar organogramin e saj (siç shihet më poshtë) dhe logon e KPK-së.



Organogrami i KPK-së

KPK-ja, në pajtim me detyrat dhe kompetencat që ka në bazë Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës¹²⁷, ka botuar Raportin e vitit 2010 për Performancën e Prokurorisë Publike të Kosovës¹²⁸.

EULEX- ka emëruar një këshilltar të përhershëm në KPK dhe do të vazhdoj të përkrah mekanizmat e llogaridhënies në Shërbimet Prokuroriale të Kosovës.

PIKËREFERIM

Çështjet kryesore me të cilat është marrë EULEX-i që nga viti 2009 për sa i përket shërbimit prokurorial të Kosovës ishin forcimi i autonomisë së prokurorëve të Kosovës, një menaxhim efektiv i lëndëve, përmirësimi i hetimeve, ndjekjes penale të krimeve të rënda, si dhe masave alternative në vend të paraburgimit.

Një veprim i MMK-së ishte dizajnuar për të arritur një sistem prokurorial efikas, efektiv dhe të qëndrueshëm në gjithë Kosovën¹²⁹. Në kuadër të metodave përshiheshin raste me ekipe të përziera, trajnim kokë më kokë, grupe diskutimi me fokus, shkëmbim i njohurive, punëtori, seanca aktualitetesh dhe mbledhje të dhënash.

EULEX-i ka punuar me KPK-në duke ndihmuar në zhvillimin e specializimit dhe qasjes shumë-disiplinore të shërbimit prokurorial. Si rezultat, në secilin rajon ekziston nga një prokuror i cili merret ekskluzivisht me rastet e korrupsionit, po ashtu është kryer një inventarizim i plotë i rasteve të korrupsionit së bashku me përpilimin e një plani operativ për të marrë masa kundër korrupsionit.

Prizreni është shembulli më i mirë i praktikës në qasjen ekipore: Kryeprokurori vendor i Qarkut mori përsipër 17 raste nga Prokuroria Komunale në mënyrë që të ndihmoj në luftën kundër korrupsionit.



Takimi i shefit të misionit me Zyrën për Programe dhe përfaqësuesit e OJQ-ve vendore

Paraburgimet ishin kërkuar pa ndonjë vlerësim më të thellë të rrethanave ekzistuese, p.sh. peshës së krimit, rrezikut nga arratisja, përsëritja e krimit, apo nga mundësia e frikësimit të dëshmitarëve. Po ashtu OSBE-ja ka venë në pah arsyetimet e dobëta në kërkesën për paraburgim, duke theksuar së nganjëherë duket se gjykatat i aprovojnë kërkesat e prokurorëve pa asnjë hezitim. Në shumë raste gjykatat kishin përdorur formulime standarde dhe stereotipike të cilat nuk i referoheshin ngjarjeve të veçanta, duke dështuar kështu të shpjegojnë bazën për heqjen e lirisë së të dyshuarve. Shqetësime janë ngritur edhe sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit: në vitin 2008 Komisioni Evropian ka vlerësuar së të paraburgosurit duhet të presin mesatarisht 1 deri 1.5 vite derisa të filloj gjykimi tyre.

Përderisa ka shënuar rritje aplikimi i disa masave më pak bezdisëse siç është arresti shtëpiak apo konfiskimi i pasaportës, prapë vazhdojnë të raportohen shumë mangësi për proceset e trajtimit të rasteve. Vonesat e shumë shprehura në trajtimin e këtyre rasteve rezultojnë në paraburgime të zgjatura e të pajustificueshme. Gjithashtu, shumica e vendimeve tregojnë një mungesë të arsytimit të fakteve që kanë qar drejt dyshimit të bazuar, ndërsa siç duket paraburgimi aplikohet në mungesë të një alternative më të mirë, dhe pa i marrë në konsideratë të gjithë faktorët relevant duke përfshirë edhe dënimin e mundshëm.

EULEX-i do të vazhdoj të monitoroj, mentoroj dhe këshilloj mbi alternativat ndaj paraburgimit siç parashihet me legjislacionin në fuqi dhe në pajtueshmëri

me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane. Në maj të vitit 2010 është futur në funksion një doracak mbi administrimin e prokurorisë (DAP) për të përmirësuar menaxhimin e prokurorisë rreth lëndëve. DAP-i parasheh një sistem transparent dhe të paanshëm të ndarjes së lëndëve në të gjitha prokuroritë komunale dhe të qarkut. Një sistem informativ për menaxhimin e prokurorisë (SIMP, krahas sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve që është në përdorim nga gjykatësit) është instaluar nëpër prokurori, së bashku me infrastrukturën e TI-së në shumë nga prokuroritë e qarqeve. Implementimi i tij i plotë është penguar nga mungesa e kapaciteteve për të mirëmbajtur sistemin. Prokurorët e rinj kanë nevojë për trajnime në mënyrë që të përdorin SIMP-in. Sipas prokurorëve vendor hapësira e pamjaftueshme për punë, mungesa e veturave dhe e stafit përkrahës po e kufizojnë njëkohësisht efikasitetin në hetimin dhe ndjekjen e krimeve të rënda.

PIKËREFERIM

Në vitin 2009 EULEX-i ka vënë re një mungesë rregullash për procedurat e testimit të provave, të cilat i udhëzojnë prokurorët kosovar gjatë vlerësimit të provave. EULEX-i po ashtu ka vërejtur nevojën që PK-ja dhe KPK-ja të përvetësojnë dhe implementojnë procedurat e testimit të provave para gjykimit. Në vitin 2010 është shënuar përparim me miratimin e procedurës së testimit të provave në tërë Kosovën.

Prokurorët e EULEX-it vazhdojnë të mentorojnë homologët e tyre vendor mbi përdorimin e formularëve të kontrollimit, bazuar në testin e provave i cili përfshin një përmbledhje të arsyeve për kryerjen e ndjekjes, provave në dispozicion, problemeve që mund të dëmtojnë ndjekjen dhe veprimet e ndërmarra për t'i zgjidhur ato probleme. Rishikimi i fundit i cili vjen pas kompletimit të hetimeve dhe para seancës vërtetuese do të përfshijë vlerësimin e prokurorit mbi gjasat reale për një dënim.

PIKËREFERIM

Që nga viti 2009 prokurorët kosovar dhe Policia e Kosovës janë bërë ekipe në baza të rastësishme ndërsa niveli i bashkëpunimit nuk ishte institucionalizuar.¹³⁰

Komunikimi në përgjithësi i dobët në mes të Policisë së Kosovës, prokurorive dhe gjykatave komunale dhe të qarkut është adresuar edhe nga KIPRED-i, i cili ka arritur në përfundimin së koordinimi i dobët i punës përben themelin e rezultateve jo të kënaqshme të hetimeve në Kosovë. Si pasojë, shumë raste mbesin të hapura apo lënda lëviz poshtë e lart në mes të prokurorëve dhe hetuesve në polici pa kurrfarë dobie thelbësore¹³¹. Në disa rajone konferencat mujore që organizohen ndërmjet EULEX-it dhe prokurorëve kosovar para seancave gjyqësore kanë treguar për bashkëpunim më të mirë në mes të Policisë së Kosovës dhe prokurorëve kosovar.¹³¹ Ka të ngjarë së autonomia e prokurorëve është përmirësuar për shkak të reformës gjyqësore të nisur së fundi. Struktura e re e sistemit prokurorial e paraqitur në Ligjin e ri mbi Prokurorinë e Shtetit¹³³ – posaçërisht shkrirja e prokurorisë komunale dhe asaj të qarkut në një – pritet që ta rris në mënyrë progresive këtë harmoni mes prokurorëve kosovar dhe Policisë së Kosovës.

LËNDËT CIVILE DHE PENALE

Konfiskimi i asetëve edhe pse i paraparë me legjislacionin e Kosovës¹³⁴, kjo masë nuk është zbatuar deri tani në ndonjë rast të rëndë penal apo ndonjë rast tjetër në përgjithësi, meqë zbatueshmëria e kësaj mase has në shumë pengesa. Moszbatimi i duhur i masave për konfiskim ka pasur një ndikim negativ në parandalimin e krimit¹³⁵; konfiskimi i pasurisë do të jetë objekt i monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Masat për lëshimin e urdhër-arresteve nacionale dhe ndërkombëtare janë të të vendosura. EULEX-i vlerëson që praktikata e tanishme të ekzekutimit të urdhër-arresteve janë në përputhje me standardet e kërkuara.

Standardet e mira janë konstatuar për sa i përket procedimit të rasteve penale për të miturit, ndërsa përmirësimet janë të nevojshme në trajtimin e viktimave të dhunës familjare si dhe në procedimet e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore.

Plani për zbatimin e kërkim marrëveshjes është iniciuar: një trajnim është zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë mbi përmbartimin e dispozitave që kanë të bëjnë me kërkim marrëveshjen.

EULEX-i inkurajon KGJK, KPK, gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës që të vazhdojnë me zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen e dëshmitarëve në krimet që involvojnë dëshmitarë të ndjeshëm dhe në krimet

PIKËREFERIM

Raporti i Programeve të EULEX-it 2009 ka shqyrtuar disa kërkesa për masa të mbrojtjes së dëshmitarëve gjyqësor nga Gjykatësit dhe Prokurorët e Kosovës për raste të veprave të rënda penale¹³⁶. Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk janë konsideruar efektive në një shoqëri shumë të afërt dhe të mbyllur të Kosovës¹³⁷, dhe njohuritë e kufizuara teknike nga gjyqësori vendor kanë qenë disa nga pengesat për ushtrimin e masave të mbrojtjes dhe kushteve për anonimitet¹³⁸.

serioze. Më pas vazhdon me mbështetje për alokim të rasteve të veprave të rënda penale, përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit gjatë seancave të veprave të rënda penale.¹³⁹ Progresi i arritur: EULEX-i ka konstatuar që ka përpjekje për të garantuar mbrojtje të dëshmitarëve

në rastet e profileve të larta. EPAP konfirmon që korniza ligjore është duke u krijuar, përmes draftimit të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe themelimin e Programit për mbrojtje të dëshmitarëve.

Gjyqtarët e EULEX-it raportojnë për një ulje të numrit të rasteve të mbajtjes nën arrest, me më pak masa imponuese të zbatuara. Megjithatë, mbetet më shumë për t'u bërë në zbatimin e qëndrimit nën arrest, posaçërisht për rastet e vendimeve të prokurorëve për të iniciuar hetimet (e mbështetura nga dëshmi të mjaftueshme). Vendimet që nuk ishin në përputhje me dispozitat ligjore janë shënuar në kuptim të zgjatjes së qëndrimit në paraburgim (zgjatja dhe periudha maksimale). Shkeljet e afatit të paraparë ligjor prej 48 orësh¹⁴⁰ janë paraqitur mes periudhës së dorëzimit të ankesës dhe dërgimit të dosjes së rastit të Gjykatës Supreme në regjistrat e Gjykatave të Qarkut.

Vlerësohet që rigjykimet e rasteve civile kanë ngulfatur gjykatat për rastet civile që nga viti 2009, duke kontribuar në shtimin e numrit të rasteve civile të pazgjidhura.

Shqetësimet gjithashtu janë ngritur për sa i përket përmbajtjes së arsytimit të gjykatësve të nivelit të dytë për gjykatësit e nivelit të parë mbi çështjet që janë ridërguar. Rrjedhimisht, EULEX-i thekson nevojën për anulimin e bazës ligjore për rigjykimet dhe që KGJK të jep një udhëzim që gjykatësit e nivelit të dytë të ridërgojnë rastet civile që të paraqesin arsytimet substanciale. Të dhënat nga KGJK tregojnë se në vitin 2010 numri i rasteve të pranuar nga Gjykatat e Qarkut në Gjykatat Komunale arrin në 65.90 % të rasteve të përfunduara (përkatesisht 24.7% raste penale, 21.5% raste civile, 18.9% raste komerciale).

Të dhënat e Departamentit për Statistika në KGJK tregojnë që numri i rasteve të pazgjidhura është shtuar për 10.17% në periudhën mes vitit 2009 dhe 2010¹⁴¹. 213967 raste janë trashëguar nga viti 2009, ndërsa

GJYKATA T	RASTET NË GJYKATA GJATË		NGA IT								
			RASTET E TRASHËGUAR A NGA VITI PARAPRAK NË		TË PRANUARA NË		NUMRI I PËRGJITHSHË M I RASTEVE TË KOMPLETUARA NË		NUMRI I RASTEVE TË NGELURA NË FUND TË VITIT		SHTIMI NË % KRAHASUAR ME RASTET E MBETURA NË FUND TË VITIT 2009
			2009	2010			2009	2010	2009	2010	
Gjykata Supreme	5693	6017	2399	2491	3294	3526	3202	3079	2491	2938	17.94%
Gjykatat e Qarkut	19643	19644	8754	9187	10889	10457	10456	8890	9187	10754	17.06%
Gjykatat Komerciale	2392	2795	1329	1541	1063	1254	851	848	1541	1947	26.35%
Gjykatat Komunale	565561	507835	173280	200748	392281	307087	364813	287743	200748	220092	9.64%
Gjithsej	593289	536291	185762	213967	407527	322324	379322	300560	213967	235731	10.17%

prej 322.324 rasteve të reja të pranuar në vitin 2010, 300.560 kanë përfunduar, që gjë ka rezultuar në gjithsej 235.731 raste të pazgjidhura deri në fund të vitit 2010 (+10.17 % në numrin e përgjithshëm të rasteve për vitin 2009). Në këtë kontekst vlen të përmendet që numri i gjykatësve është ulur nga 176 sa kishte në vitin 2009 në 158 në vitin 2010.

Një numër i përgjithshëm prej 104.777 rasteve civile dhe 13.429 rasteve penale mbeten akoma të papërfunduara deri në fund të viti 2010, duke shtuar kështu për 17.5 % përkatësisht 4.4 % shifrat për vitin 2009 (95.306 raste civile dhe 6.753 raste penale), Raporti i GNK konsideron që efektshmëria e gjyqësorit është duke u penguar nga mungesa e përmbarimit të vendimeve të gjykatave.¹⁴²

EULEX-i ka rekomanduar një numër më të madh të zyrtarëve në gjykata për të proceduar përmbarimin e

rasteve.¹⁴³ BIRN ka theksuar që mungesa e ekzekutimit të vendimeve në gjykatat komunale është për shkak të mosekzekutimit të vendimeve brenda kornizës kohore të arsyeshme dhe ka raportuar që numri i zyrtarëve për të kryer këtë funksion nuk është i mjaftueshëm për sasinë e vendimeve të paekzekutuara. Për më tepër gjykatat gjithashtu kanë njoftuar që mungesa e automjeteve për punë në terren ka qenë një nga shkaktoret për nivelin e ulët të ekzekutimeve.¹⁴⁴

Gjyqtarët e EULEX-it që monitorojnë rastet civile kanë konstatuar praktikën e shtyrjes së ekzekutimit nga gjykatat e nivelit të parë derisa të përfundojnë ankesat. Kjo praktikë është në kundërshtim me ligjin dhe ka kontribuar në zgjatjen e ekzekutimeve dhe rritjen e numrit të rasteve të pazgjidhura. Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it ka sugjeruar dërgimin e dosjes origjinale të rastit në gjykatën e nivelit të dytë në rast apeli, dhe mbajtjen e kopjes së dosjes së rastit në gjykatën e nivelit të parë për procedurë të ekzekutimit. Kjo këshillë është duke u zbatuar në shumicën e gjykatave dhe ekzekutimi i rasteve civile në apel vazhdon.



Kur u krahasuan rastet e përfunduara me rastet e pranuar, në vitin 2010 efikasiteti i gjyqtarëve¹⁴⁵ u shtua për 41.37% për rastet civile dhe për 90.82 % për rastet penale¹⁴⁶. Dhe vërtet Strategjia Kombëtare e KGJK-së për Uljen e Numrit të Rasteve të Pazgjidhura duket të ketë arritur efekte pozitive. Ekipi përgjegjës për implementimin e strategjisë është duke shënuar progres edhe në fusha të tjera (p.sh përpilimi i rregulloreve për normën e barrës së punës dhe stimulimet për gjykatësit/zyrat). Plani i strategjisë gjithashtu mundëson shqyrtimin e legjislacionit ekzistues për të propozuar plotësim ndryshimet përkatëse, që gjithashtu mbulon çështjen e rigjytimeve. Praktika e nivelit të dytë që sistematikisht të ridërgojë rastet për rigjykim në nivelin e parë ka rezultuar në barrë për të gjitha palët, dhe kërcënon funksionalitetin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Prandaj kjo praktikë duhet korrigjuar. Dërgimi i rasteve për rigjykim përbën një përjashtim dhe nuk duhet që asnjëherë të përbëjë një rregull. Ai është një vendim i cili duhet të merret parasysht me kujdes në nivelin e dytë dhe të miratohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Gjyqtarët e EULEX-it kanë diskutuar këtë çështje me gjykatësit e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe janë pajtuar në parim që të përcillet në të gjitha apelet ndaj vendimeve të nivelit të parë, të cilat sipas gjykatës së nivelit të dytë, nuk i ka vënë faktet në mënyrë korrekte dhe të qartë. Në këtë rast gjykata do të ketë këto opsione procedurale:

- bëj një vlerësim të ri të dëshmive që janë në dosjen e rastit dhe të përcaktojë faktet në një mënyrë të qartë dhe korrekte në vendimin e nivelit të dytë (Nenet 424.4, 426.1 KPPK/neni 381.1 në përputhje me KPPRSFJ).
- të caktojë një dëgjim në nivelin e dytë për të përcaktuar faktet (nenet 441 dhe 413.4 KPCC/ nenet 372 dhe 373.1 KPPRSFJ.)
- Të dërgojë rastin për rigjykim në gjykatën e nivelit të parë, nëse marrim parasysht që ky opsion duhet të ushtrohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur nuk është e mundur që të përcaktohen faktet në nivelin e dytë sipas paragrafëve të mësipërm 1 dhe 2 (Neni 424.1 in fine / Neni 385.1 CCPFSRY)
- të lirojë të pandehurin mbi bazën e mospasjes së dëshmive të mjaftueshme për të mbështetur akuzat, duke patur parasysht që ky opsion duhet të ushtrohet vetëm nëse nuk është e mundur që faktet të përcaktohen ashtu siç parashihen me paragrafët e sipërpërmendur një, dy dhe tre, (neni 420.4 lexuar në varësi të neneve 390.3 KPPK / neni 381.1 për gjobë, lexuar në varësi të neni 350.3 CCPFSRY).

MINISTRIA E DREJTËSISË DHE DEPARTAMENTI PËR MJEKËSI LIGJORE

Vlerësimi i EULEX-it për vitin 2009 ka identifikuar një numër të mangësive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Zyrës për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (ZPPML). Ato kanë të bëjnë me përpilimin e dobët të politikave dhe mungesën e aftësive për përpilim ligjor, kapacitete të dobëta në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar brenda MD, dhe zbrazëtira në punën e ZPPML, në veçanti të Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Korniza ligjore për zhvillimin politikave ligjore dhe legjislacionit mbetet një ndër sfidat kryesore për MD ¹⁴⁷

Ministri i Drejtësisë (MD) ka marrë përgjegjësitë në fushën e Asistencës Juridike Ndërkombëtare (AJN) bazuar në Udhëzimin Administrativ të datës 20 Mars 2009 – duke shtuar kështu kompetencat edhe për pranimin dhe dërgimin e kërkesave edhe për shtetet të cilat “nuk e kanë njohur Kosovën”. ¹⁴⁸

Kjo më pas është shoqëruar me një Udhëzim Administrativ për gjykatat e Kosovës, të cilat kanë përcaktuar procedurat për kërkesa dhe përgjigje për asistencë juridike ndërkombëtare.

Bartja e kompetencave për AJN nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut tek institucionet vendore duke ndërprerë kështu gjithë komunikimin me Serbinë – e cila përfaqësonte 30% të të gjitha kërkesave ¹⁴⁹. Autoritetet serbe vazhdojnë që të refuzojnë kërkesat nga Kosova duke mos njohur vultat apo simbolet e dokumenteve që vijnë nga institucionet e Kosovës.

Që nga maji 2011 Njësia për AJN në MD është shenduar në një Departament me dy njësi: Njësia për Bashkëpunim Gjyqësor Ndërkombëtar dhe Çështje Civile dhe Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Zyra tani bashkërendohet drejtpërsëdrejti nga Ministri dhe rregullimi i ri pritet që të rrisë efikasitetin. Të gjitha pozitat për vende pune janë plotësuar në fillim të vitit 2011.

PIKËREFERIM

Mangësitë në ekipin e përkthyesve dhe mungesa e opsioneve alternativë kanë qenë ndër shqetësimet kryesore të theksuara nga EULEX-i në vitin 2010, që shkaktojnë pengesa reale për Kosovën për të respektuar standardet ndërkombëtare dhe dërguar kërkesa në gjuhët zyrtare të vendeve pranuese. ¹⁵¹

Ligji mbi Rrëmbimin Ndërkombëtar të Fëmijëve ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës në shtator 2010. Ministria e Drejtësisë ka informuar Konferencën e Hagës mbi Ligjin Privat Ndërkombëtar për miratimin e Ligjit të ri mbi Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve nga Kuvendi, duke kërkuar kështu asistencë dhe mbështetje për zyrtarët kosovarë. Ligji mbi asistencën juridike ndërkombëtare në çështjet penale është përpiluar dhe dërguar në Kuvend për lexim të parë në muajin korrik 2011. Ka një fokus të ripërtërirë të EULEX-it mbi kapacitetet ligjore të Ministrisë së Drejtësisë në kuptim të konventave ndërkombëtare dhe acquis së BE-së, duke ndërtuar mbi marrëveshjet ekzistuese dhe ato potenciale, si dhe zbatimin e praktikave më të mira evropiane përmes mbështetjes aktive të MMK. MD ka propozuar 30 draft marrëveshje me shtete të ndryshme të BE-së dhe rajonit mbi transferimin e personave të dënuar. E para nga 30 marrëveshjet e propozuara ka qenë marrëveshja bilaterale mes Belgjikës dhe Kosovës mbi transferimin e personave të

Eulex Programme Report 2011
Bolstering The Rule Of Law In Kosovo: A Stock Take

dënuar, që është nënshkruar në qershor 2010 dhe ratifikuar
më 21 shtator.



Forensic Medicine

Në prill 2011, janë nënshkruar tri marrëveshje për bashkëpunimin ndërkombëtar (marrëveshja për ekstradimin, asistencën reciproke juridike dhe transferimin e personave të dënuar) mes IRJM dhe Kosovës. Marrëveshjet hyjnë në fuqi posa të ratifikohen.

Në maj 2011 janë nënshkruar tri marrëveshje nga AJN mes Turqisë dhe Kosovës, si p.sh për ekstradim, transfer të personave të dënuar dhe asistencë reciproke juridike¹⁵².

Negociatat mes Kosovës dhe Zvicrrës mbi Marrëveshjen për transferimin e personave të dënuar është finalizuar.

Diskutimet për përmbylljen e marrëveshjeve juridike ndërkombëtare janë duke vazhduar edhe me Slloveninë, Italinë, Bullgarinë. Shqipërinë dhe Gjermaninë. EULEX-i ofron mbështetje procesit të negocimit.

Një delegacion nga MD gjithashtu është ndihmuar në vizitën e tyre për në Gjermani për të negociuar një marrëveshje gjithëpërfshirëse në fushën e Asistencës reciproke juridike. Është iniciuar edhe bashkëpunimi me Njësinë e Bashkimit evropian për bashkëpunim gjyqësor (EUROJUST). Delegacioni i EUROJUST-it është takuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të shtimit të luftimit kundër krimit transnacional. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në marrëveshjet bilaterale ndërkombëtare, dekreti presidencial për anëtarësim në marrëveshjet Austri-IRJ mbi AJN është ratifikuar më 9 qershor 2011.

Objektiva specifike ishte krijimi i një njësie të eskortit të Kosovës për ekstradim. Në mungesë të funksionimit të njësisë së eskortës në MD, EULEX-i ka ndihmuar eskortat e personave të ekstraduar në Kosovë. Njësia e Eskortës së Kosovës është bërë operacionale dhe me sukses ka kryer disa ekstradime.

Departamenti për Mjekësi Ligjore (DML) ka marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë që më herët i takonin zyrës për persona të pagjetur dhe mjekësi ligjore, dhe drejtori i ri do të duhet që të bëjë departamentin operativ dhe të punojë në strategjitë si dhe të përballë me problemet menaxheriale dhe logjistike. Vështirësitë e grumbulluara kanë kontribuar në shtimin e numrit të rasteve të pazgjdhura që kanë penguar punën e prokurorëve. Puna e DML është penguar edhe nga protestat e stafit që kërkonin paga më të larta, duke përkeqësuar kështu tutje ofrimin e shërbimeve . Përkundër sfidave, ekzistojnë disa zhvillime pozitive:



Forensic work in the field

Ligji për Themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore (DML) ka hyrë në fuqi në gusht 2009. Legjisacioni sekondar për Ligjin mbi themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore është duke u përpiluar. Ligji mbi procedurën e mjekësisë ligjore ka hyrë në fuqi në qershor 2010. Ligji është konsideruar të jetë një sukses madhor edhe një hap i rëndësishëm për krijimin e kornizës ligjore për mjekësinë ligjore dhe disiplinat e saj. Resurset e mjekësisë ligjore në Kosovë janë të centralizuara

në kuadër të Departamentit për Mjekësi ligjore (duke përfshirë këtu njësinë e KP për mjekësi ligjore) gjë që mundëson një menaxhim më koherent dhe zhvillim eventual.

Sinjale për ndikim politik dhe menaxhim të dobët janë raportuar në vitin 2010 ¹⁵³ Pengesat e hershme teknike të DML-së kanë rezultuar në mungesën e shërbimeve cilësore të ofruara, dhe ngritja e kapaciteteve të stafit vazhdon të neglizhohej.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS(SHKK)

Njësia korrektuese e EULEX-it (NJK) ofron asistencë teknike dhe mbështetje kyçe Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK). Është zhvilluar një Program i përbashkët MMK për fushat e kryesore siç janë Siguria dhe Operacionet, Menaxhimi i të Burgosurve, Menaxhimi strategjik dhe Administrata. Fushat e sigurisë fizike dhe “dinamike” akoma mbeten sfidat më të mëdha për SHKK, kur kemi parasysh të gjitha aspektet e

ngritjes së kapaciteteve që janë të involvuara. Renovimi i fundit i objekteve të sigurisë ka përfshirë edhe modernizimin e sistemit të CCTV në Burgun e Dubravës dhe prokurimin e pajisjeve shtesë të sigurisë për të përmirësuar sigurinë në burgje. EULEX-i ka ndihmuar SHKK në përmirësimin e sigurisë përmes huazimit të tri pajisjeve me rreze-X. Dy nga këto pajisje janë instaluar në hyrje në Dubravë dhe një në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë.

NJK e EULEX-it dhe KGJK ka zhvilluar edhe një trajnim të bazuar në praktikën më të mira për të njoftuar stafin me pajisjet e reja dhe procedurat e hulumtimit. Trajnimi e vijuan gjithsej 36 pjesëtarë të stafit të SHKK, përfshirë këtu edhe 5 zyrtarë nga Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë, ndërsa 7 prej tyre vijuan trajnimin për trajnerë. SHKK tani është autonome në trajnimin e stafit në këtë lëmi. Si rezultat i kësaj, një sasi e mallrave të kontrabanduara janë detektuar dhe konfiskuar, dhe në disa raste të nevojshme ka asistuar edhe Policia e Kosovës. Pajisjet me rreze-X kanë modernizuar praktikën hulumtuese të SHKK-së dhe kanë vepruar si siguries vizual kundër kontrabandës. Komisionari i SHKK gjithashtu ka lëshuar një direktivë të re mbi menaxhimin e aseteve të konfiskuara.

Një program formal mentorues i EULEX-it ka ndihmuar SHKK për të përmirësuar menaxhimin e resurseve njerëzore dhe administrimin e qendrave të paraburgimit dhe burgjeve. Presioni për të trafikuar ilegalisht gjësende në objektet e burgjeve është pasojë e drejtpërdrejtë e frikësimit të burgosurve. Ky problem është më akut në Dubravë. Menaxhmenti i SHKK dhe NJK e EULEX-it kanë shënuar progres në luftimin e kësaj dukurie.

Pas Vlerësimit për nevoja të trajnimit të zhvilluar në prill 2010, Monitoruesit e EULEX-it për Korrektuesen kanë punuar dhe mbështetur menaxherin e trajnimeve në Burgun e Dubravës, në ofrimin e trajnimeve themelore gjatë vitit të kaluar, që ka përmbytur:

Raportimin për Informacione të Sigurisë: Trajnimi është zhvilluar përmes seminareve që iu kanë adresuar të gjitha niveleve të pjesëtarëve të stafit të SHKK, dhe është dëshmuar i suksesshëm meqë rrjedha e raporteve të informacioneve është shtuar. Shifrat tregojnë që 450 pjesëtarë të stafit janë trajnuar, përfshirë këtu edhe stafin civil.

Programi i mentorimit formal: Mentorimi Formal është zhvilluar nga mbikëqyrësit e bllokut të NJK e EULEX-it për stafin e SHKK që punonte në bllokun e sigurisë së lartë në Dubravë: janë mentoruar gjithsej 52 pjesëtarë të të gjitha rangjeve në SHKK. Është planifikuar që të zgjerohet programi dhe të përfshijë edhe stafin e ri në bllokun e rrezikut të lartë; programi do të administrohet nga grada e mbikëqyrësve në SHKK dhe menaxheri i


trajnimeve në SHKK. NJK e EULEX-it do të monitorojë implementimin e programit. Drejtori i Burgut do që ky program të zbatohet në të gjitha lëmit tjera të burgut.

Programet që kanë të bëjnë me menaxhimin e popullsisë së të burgosurve kanë shënuar përmirësime kudo në SHKK, gjithashtu duke iu falënderuar edhe fokusit specifik që përmban Planin Strategjik i SHKK për vitin 2011.

SHKK aktualisht është duke përdorur dokumentin për planifikimin e dënimeve i cili pasqyron rekomandimet nga Këshilli i Evropës Shtojca e Rekomandimeve (2003)23-Planifikimi i Dënimeve 9-10. Politika për Regjimin e të burgosurve është duke u formuluar dhe pritet të autorizohet nga Komisionari. Vizitat e të burgosurve vazhdojnë të funksionojnë si duhet në të gjitha burgjet e Kosovës, dhe kohëzgjatja e tyre është rritur sipas rekomandimit të EULEX-it.

Sfidat e ngelura janë a) numri i pamjaftueshëm i Punëtorëve Social të SHKK në Burgun e Dubravës për të zbatuar efektivisht Planifikimin për Dënime për të gjithë të burgosurit; b) Mungesa e programeve moderne rehabilituese për të gjithë të burgosurit, si p.sh rehabilitimi nga droga; c) vendosja e kategorive të ndryshme të të burgosurve në një bllok të njëjtë.

MD ka planifikuar që të kalojë çështjet që kanë të bëjnë me Resurse Njerëzore tek SHKK gjatë vitit 2011. SHKK ka nevojë për kohë adekuate dhe mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që të mund të menaxhojë në mënyrë të pavarur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me resurset njerëzore, siç janë rekrutimi, dosjet e stafit, çështjet disiplinore, analiza të stafit, ekzekutimi i pagesave. Bartja e Resurseve Njerëzore do të pasohet edhe nga bartja e buxhetit dhe prokurimit. Kontrolli direkt i SHKK mbi fondet dhe prokurimin do të rrisë kapacitetin e tij në planifikim afatgjatë dhe efektivitetin e kostos. Kjo do të jetë një mundësi tjetër sfiduese për SHKK dhe një hap i domosdoshëm për t'u bërë agjenci e pavarur dhe llogaridhënëse. Një gjë e tillë do të ndihmonte në fushat e dobëta siç janë furnizimi i burgjeve (mungesa e ushqimeve e medikamenteve ka shkaktuar një grevë urie dhe forma tjera të protestës në mesin e të burgosurve), rekrutimi dhe zhvillimi i stafit të SHK.



SHKK ka përvojë të kufizuar në buxhet, financa dhe menaxhim të prokurimit andaj edhe asistenca dhe këshillimi nga ana e misionit do të vazhdojë të ofrohet mbi këto çështje.

Që nga tetori 2010 një grup punues SHKK/EULEX është duhet shqyrtuar udhëzimet administrative për të siguruar konsistencë me Ligjin e ri mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Ndëshkimore (LESN). Grupi punues ka përgatitur udhëzime shitesë për të përmbushur të gjitha kushtet e parapara me Ligjin e ri.

SHKK ka konstatuar që përmirësime duhen arritur edhe sa i përket strategjisë për resurse njerëzore. Është bërë një analizë e nevojat për stafin për të adresuar dobësitë aktuale organizative: struktura organizative në zyrën qendrore; struktura e përgjithshme e hierarkisë; mungesa e ekspertëve në fusha specifike, të gjitha këto janë çështje që meritojnë një menaxhim të kujdesshëm. SHKK gjithashtu

mendon që duhet të përmirësohet edhe raporti stafit të burgosur, dhe që stafi ekzistues mund të riorganizohet nëpër objekte të tjera ashtu siç do të funksionalizohen ato, duke iu përshtatur kështu rialokimit të resurseve financiare për nevojat e tjera.

Zhvillimi i një sistemi të centralizuar informativ/baze të dhënash në SHKK kërkon ekspertizë dhe resurse të qëndrueshme financiare. Nevojitet një asistencë e donatorëve ndërkombëtar për bazën qendrore të të dhënave. Mungesa e bazës nacionale për të dhënat dhe sistemit të regjistrimit ndikon në të gjitha fushat e menaxhimit të SHKK të burgjeve, administratës dhe operacioneve. Që nga korriku 2011 SHKK nuk mund të mbledhë informacione mbi shkallën e recidivizmit, prandaj edhe mbeten të vështira planifikimi i rehabilitimit efektiv dhe riintegrimi shoqëror.

Në raportin e vitit 2009, EULEX-i ka vlerësuar miratimin e legjislacionit primar për DK kah fundi i vitit 2008. Ligji për Doganën ishte në përputhje me standardet, i frymëzuar nga 'Ligji i Komunitetit të Doganës Evropiane. Ngjashëm Komisioni Evropian (EC) ka raportuar për progres në fushën e doganës : shërbimi ka marrë kriteret e reja të BE-së për doganën, duke aplikuar kështu kriteret e bazuara në praktikat më të mira për të vlerësuar kapacitetet operative dhe krijuar planet për reformimin e ardhshëm të doganës si dhe harmonizimin me rregullat dhe standardet ndërkombëtare ¹⁵⁴.

Raporti i Progresit të KE për Kosovën për vitin 2008 ka konstatuar që DK është në përputhje me standardet evropiane dhe ka vërejtur përmirësime relative në operacionet e shërbimeve doganore të Kosovës. Me qëllim të asistimit dhe përmirësimit të zbrazëtirave dhe shqetësimeve të ngritura, EULEX-i ka përpiluar një sërë rekomandimesh për të përmirësuar shërbimin në fjalë ¹⁵⁵. Rekomandimet aso kohe u strukturuan në katër veprime mentorimi, monitorimi dhe këshillimi të cilat më pas u definuan në kuptim të qëllimeve dhe rezultateve.

Një prej fushave të interesit për EULEX-in ishte mentorimi dhe këshillimi i Drejtorit Gjeneral të Doganës së Kosovës dhe Drejtorëve në planet e përditësuara operative, përfshirë këtu strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) dhe strategjinë e qeverisë për luftë kundër krimit të organizuar. Prandaj EULEX-i fokusohet në mentorimin dhe këshillimin mbi mënyrën sesi të përfshihen planet nga drejtorate të ndryshme në një plan të vetëm të konsoliduar i cili në mënyrë të qartë definon objektivat dhe përgjegjësitë. Vëmendje e posaçme iu është kushtuar integritetit të



të të gjitha elementeve të miratuara të Strategjisë së MIK dhe strategjisë së ardhshme të qeverisë për të luftuar dhe parandaluar krimin e organizuar.

PIKËREFERIM

Vlerësimi i parë i draft planeve operative të drejtorive për vitin 2009 ka treguar standarde të pabarabarta të cilësisë, nga aktivitete shumë të detajuara deri në ato shumë të përgjithësuara pa përcaktuar rezultate konkrete. Në përgjithësi, duhet të mos ketë integrim apo konsolidim të planeve operative në një plan të vetëm me objektiva të qarta për tërë DK.

DK në fillim të vitit 2010 ka përpiluar Kornizën Operacionale të Strategjisë (KOS) për periudhën 2010-2012. Kjo KOS është vlerësuar nga këshilltarët e EULEX-it në mars 2010 dhe komentet janë ndarë me DK. Dokumenti që ka rezultuar është fokusuar kryesisht në vitin aktual por ka patur mangësi të vizionit specifik dhe fushave kryesore për vlerësim të performancës për periudhën e synuar. Rekomandimet përmbanin kërkesën për strukturimin e përmbajtjes së KOS në kuptim të "Vizionit, Vlerave dhe Objektivave Strategjike" gjatë zhvillimit të tri strategjive kryesore: biznesi/klienti, fuqizimi i ligjit (përfshirë këtu kontrollin doganor), dhe strategjinë e resurseve. Planet e veprimit apo planet operative atëherë do të ishin në harmoni të plotë me kornizën kohore të KOS.

Versioni final i KOS është lëshuar dhe bazuar në këtë Kornizë, DK ka përpiluar Planin e Veprimit për vitin 2010; dhe natyra e integruar e këtij plani të ri korporativ ishte e dobishme.

MIK dhe strategjitë nacionale për Krimin e Organizuar janë përmendur në KOS të MIK 2010-2012, si pjesë përbërëse e një objektivë të vetme; këto strategji përshkruhen në më shumë detaje në Planin e Veprimit të DK për vitin 2010, e cila është një shtojnë në KOS.

Drejtori Gjeneral i DK ka ndryshuar sistemin paraprak, kur çdo drejtori ka patur Planin e vet Operativ (PO), dhe ka krijuar një PO unik dhe të përbashkët, duke përcaktuar objektiva të qarta për tërë Organizatën. Koncepti i ri përmban detyrat individuale dhe në nivel të korporatës

të Kosovës. Këto trajnime janë përqendruar në parimet e kryerjes së detyrave policore të bazuar në inteligjencë, të cilat sipas reagimeve të para janë pranuar mirë nga zyrtarët e Doganës¹⁵⁸.

PIKËREFERIM

Vlerësimi i par[i zhvilluar nga EULEX-i ka ardhë në përfundim që ekziston nevoja e një shqyrtimi të detajuar për të kontrolluar gjithë regjistrat ekzistues dhe metodat për procesin e analizës së rrezikut brenda DK

si dhe përgjegjësitë për drejtoritë. Kontrollat e automjeteve dhe gjësendeve janë bazuar në SMIT (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Tregtar) për vlerësimin e rrezikut i cili jep detyra kontrolli zyrtarëve doganor derisa deklarimet për doganime po procesoheshin: sistemi i përmendur do të zgjidhte automatikisht çështjen e kontrollimit të automjeteve dhe të gjësendeve cilat duhej të kontrolloheshin. Ekspertët e EULEX-it nga terreni kanë ardhë në përfundim që përdorimi i SMIT-it do të duhej rishqyrtuar, sepse është konstatuar një përqindje e madhe e masave të kontrollit të cilat nuk janë bazuar në përzgjedhje, dhe nuk ishte e qartë nëse profilet ishin rezultat i vlerësimit të rrezikut. Një situatë e ngjashme është vërejtur edhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, gjë që ka treguar në nevojën për më shumë trajnime të stafit të doganës në profilim dhe vlerësim të avancuar të rrezikut¹⁵⁷.

Zyrtarët doganorë të Kosovës kanë marrë pjesë edhe në modulet e trajnimit të mbajtura nga KE mbi "Fuqizimin e Sundimit të Ligjit" Projektin binjakëzues për Policinë Kufitare

Vlerësimet kanë vërtetuar që ka një shfrytëzim të mangët të të dhënave inteligjente në Doganën e Kosovës. Çështjet teknike si dhe mungesa e një sistemi të mirëfillt të TI, dhe baza e të dhënave kompatible me nevojat për inteligjencë mbeten akoma të pazgjidhura. Në mars 2011 planifikimi i bazës së të dhënave është kompletuar nga DK, me asistencë nga BE-CTA. Financimi i bazës së re të të dhënave duhet të sigurohet nga donatorët ndërkombëtar.

